



DIJA ËSHTË PUSHTET

Jemi në fillimin e muajit shtator. Shtatori simbolizon fillimin e vitit shkollor. Fillimi i vitit shkollor na kujton përsëri rëndësinë që duhet të ketë dija në jetën tonë, por fatkeqësisht edhe shkujdesjen që vërejmë anembanë shoqërisë tonë ndaj dijes dhe procesit të nxënies së saj. Feja islame ka një qëndrim shumë të qartë dhe të prerë në lidhje me këtë temë. Dija është boshti i Fesë Islame për dallim nga fetë dhe ideologjitë e tjera. Feja Islame fillon me ajetin e parë të shpallur: **“Lexo në emër të Zotit tënd që të ka krijuar...”** dhe pa dyshim se kjo na flet shumë për rëndësinë që ka dija në njohjen e Allahut, Krijuesit tonë dhe në njohjen e rrugës, e cila na shpie tek Allahu. Prandaj Allahu Fuqiptotë na mëson që të fillojmë ta njohim madhërinë e Allahut e pastaj të fillojmë me veprimet konkrete, duke na thënë: **“Atëherë, dije se nuk ka të adhuruar tjetër pos Allahut, kërko falje për mëkatin tënd...”**. (Muhamed: 19).

Allahu i Lartmadhërihëm, e ka mësuar të Dërguarin e Tij, Muhamedin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, që të kërkojë nga Allahu dije, sepse kjo është begatia më e madhe që mund të ketë një njeri në jetën e tij e ka thënë: **“...thuaj: “Zoti im, më shto dituri!”**. (Taha: 114).

Fillon feja me dije, njihet Allahu me dije, i lutemi Allahut të na e shtojë dijen, dhe dija është rruga e vetme, e cila na mundëson të arrijmë tek Allahu i Plotfuqishëm, prandaj dija edhe i jep pushtet njeriut në dynja dhe grada të larta në jetën e amshueshme të ahiretit. Për këtë shkak i themi rinisë tonë shqiptare le të mësojë, le të studiojë, le të stolisen me vlera morale dhe le të punojë për të përhapur shkollimin, arsimimin dhe edukimin, sepse pozita më e lartë tek Allahu dhe në shoqëri fitohet me dije dhe mësim. Shpesh u ndodh të rinjve të mashtrohen, e të ëndërrojnë të bëhen politikanë, sepse do të kenë pushtet, famë madje edhe pasuri, mirëpo këshilla dhe porosia jonë është që ata të bëhen shkencëtarë dhe akademikë, se pushteti i vërtetë është pushteti i dijes, është pushteti i realët, faktik dhe afatgjatë për dallim nga pushteti politik i sotëm, i cili është afatshkurtër dhe përplot me turpe dhe degjenerime morale e kombëtare. Jeta jonë e përditshme është argumenti më i madh për atë që po themi.

U themi edhe veteranëve të arsimit, arsimdashësve, dashamirëve të librit dhe të leximit, është e vërtetë që shoqëria nuk jua ka vlerësuar mundin, ju kanë harruar, politika nuk merret me ju, sepse ka punë më të “mëdha”, mirëpo ju duhet të jeni të kënaqur, sepse keni bërë rolin e të Dërguarve të Allahut, të cilët kanë qenë mësuesit e popujve të tyre dhe vazhdojnë të jenë me mësimet dhe sqarimet e tyre edhe këto ditë. I lumtë atij mësuesi, i cili në mësimet e veta e ndihmon shoqërinë të pajiset me informata dhe dije akademike, por njëkohësisht edhe e pajis me moral dhe edukatë, e cila vjen si rezultat i besimit tek Allahu Fuqiptotë. Dija pa moral shndërrohet në një bombë për shkatërrim masiv, kurse morali pa dije e shndërron shoqërinë në një shoqëri pasive. Prandaj ne e thërrasim popullin tonë, të rinjtë dhe të rejat, pleqtë dhe plakat, burrat dhe gratë, të gjitha shtresat që të jepen pas dijes, të mësojnë, të lexojnë dhe të studiojnë, sepse kjo të jep kënaqësinë e vërtetë në dynja e në ahiret.

Mos u mërzitni pse u afrua fillimi i vitit shkollor, por gëzohuni dhe jini të kënaqur, sepse dija është pushteti i vërtetë!

Në emër të redaksisë: Bekir HALIMI

AKTUALE

Mëshira e Allahut kaploi dhe Çairin **3-4**
Diskriminimi ndaj “tjetrit” **5-8**

KËNDI IM

Ja si lexohen librat **9-11**
Krim ndaj Islamit dhe mashtrim ndaj shqiptarëve **12-14**
Vetëvrasja - anomali që ka zgjidhje **15-18**

AKIDE

Fitneja e bashkimit të kufrit me forcën materiale **19-22**
Zoti, i madhërishmi **23-27**

FIKH

Si ta kërkosh dijen perla dhe margaritarë për nxënësin e dijes **28-32**

AVANCIMI PERSONAL

Thelbi i vlerës personale **33-35**

LIBRI

Prezantim i librit: “Kitabu Teuhid” **36-39**

FAMILJA

Kush i edukon fëmijët tanë **40-42**

TEFSIR

A i njeh dijetarët **43-46**

HADITH

Ne jemi umeti i “*Ikre-s*” **47-52**

BOTA ISLAME

Republika e Guajanës **53**
Republika e Guinesë **54**
Republika e Guinea Bisao **55**

FETVA DHE KONSULTIME

Kërkoje natën e Kadrit **56-58**

HISTORI

Nga përvoja e Shejh Akil ibën muhamed maktiriut
Përkrahja e gruas **59-60**

REDAKSIA

Omer BERISHA – kryeredaktor
Anëtarë të redaksisë:

Ahmed KALAJA, Bekir HALIMI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Ali SHABANI, Ismail BARDHOSHI,
Talha KURTISHI, Bledar HAXHIU, Sedat SHABANI, Agron TERZIQI, Lulzim SUSURI, Genc PLUMBI, Zeki ÇERKEZI,
Enver AZIZI, Bashkim BAJRAMI, Bilal TEQJA.

Bashkëpunëtorë: Ekrem AVDIU dhe ENIS RAMA
Roald HYSA – redaktor gjuhësor
Halil BERISHA – redaktor teknik
Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio) - ballina
Sedat RAMADANI - shpërndarje dhe marketing

Boton: AlbIslam

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000
email: albislam@gmail.com
sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827
Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për
Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2
ISSN: 1409-6250
Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR
Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)
e-mail: albislam.abonues@gmail.com
ALBISLAM DOOEL
Xhironlogaria: 30000002770453
Komerçijalna Banka A. D. – Skopje
Numri tatimor: 4030008038784

Abonimet me euro mund t'i bëni online nëpërmjet shërbimit
PAYPAL. Të dhënat mund t'i gjeni në www.revista-albislam.com

SOFRA E IFTARIT 2009



MËSHIRA E ALLAHUT KAPLOI DHE ÇAIRIN

A thua vallë, e morën mesazhin të gjithë skeptikët, se Çairi mund të lulëzojë, mund të jetë vatër ku të dëgjohet fjala e mirë, ku do të punohen vepra të mira, ku i pasuri dhe i varfëri do të jenë së bashku.

SHKRUAN: HAJRUSH MANI

Tashmë kur i jemi afruar mesit të muajit të shenjtë, Ramazanit, nuk mund të rrija dot pa i shprehur emocionet e mia për ato që po përjetojmë në kryeqytetin e vendit tim, Shkupin. Është bërë shprehi këto vitet e fundit, që kur përmendet lagjja e Çairit të mendohet vetëm për të keqen, dhunën dhe krismat e plumbave. A thua vallë, e morën mesazhin të gjithë skeptikët, se Çairi mund të lulëzojë, mund të jetë vatër ku të dëgjohet fjala e mirë, ku do të punohen

vepra të mira, ku i pasuri dhe i varfëri do të jenë së bashku.

Posa të futesh në parkun e gjelbër, dëgjoen vargjet e ilahive, duke të uruar mirëseardhjen në sofrën e madhe të Ramazanit. Njerëzit u afrohen me buzëqeshje ulëseve duke u përshëndetur me njëri-tjetrin me përshëndetjen më të mirë *“Esselamu Alejkum ue Rahmetullahi ue Berekatuhu – Paqja, mëshira dhe begatitë e Allahut qofshin për ju”*.

Edhe unë isha pjesë e një iftari. Aroma e gjellës të përkujton se po afrohet koha e iftarit, kur e gjithë bota islame fillon me

ngrënien e ushqimit.

Të rinjtë dhe vullnetarë të tjerë me lehtësi shërbejnë, ndërsa ezani paralajmëron fillimin e iftarit. Gjithçka sipas rregullit, gjithçka në vend të vet, hurma e ëmbël për të cilën na ka mësuar Resulullahu, është e pashmangshme në nisjen e iftarit. Me përfundimin e iftarit të gjithë bëhen gati për namazin e akshamit, që më pas të vazhdojnë secili sipas planeve që ka bërë.

Kështu është vepruar që nga fillimi i muajit të bekuar të Ramazanit, kur SHQA. **“Bamirësia”** me aktivistët e saj të shumtë ndërmoi një hap të tillë, që për 29 ditë rresht, veprat e mira dhe mëshira e Allahut ta kaplojë edhe këtë pjesë të nënqiellit tonë.

Kur shikojmë të kaluarën tonë e marrim vesh se sa shpejt ecën koha. Shumë shpejt nga rinia kalojmë në gjysmë moshë, kurse nga gjysmë mosha në pleqëri. Me të vërtetë çfarë kemi përfituar nga këto vite, që na kanë kaluar dhe çfarë kemi siguruar diçka të vlefshme për veten tonë? Emocionet e kota dhe shqetësimet e jetës janë duke na bërë neglizhentë dhe janë duke na munduar vazhdimisht shpirtin. Por në mes të këtyre ditëve, të cilat ndjekin njëra-tjetrën, përpara kemi disa ditë apo disa orë që kanë një dritë tepër të shkëlqyeshme. Ditët e muajit Ramazan janë shumë të kufizuara. Por këto ditë janë plot mëshirë dhe falje, që neve na dhurojnë mirësi dhe forcë, me qëllim që në mes të kësaj jete plot brenga të ringjallim njerëzinë dhe devotshmërinë.

Muhamedi, paqja dhe bekimet qofshin mbi të, e ka emëruar muajin e Ramazanit, si muajin në të cilin hapen dyert hyjnore. Adhurimi i quajtur Agjërim në këtë muaj e ngre njeriun në shkallën më të lartë njerëzore dhe shpirtërore. Ky muaj i dhuron njeriut momente të lumtura dhe plot me ndjenja të këndshme. Por për ta arritur këtë lumturi duhet një përpjekje e mençur dhe

shpirtërore. Të shumtë janë ata njerëz që e humbin muajin e Ramazanit pa përfituar asgjë për veten.

Veprat e mirësisë në këtë muaj nuk kanë fund, prandaj duke u munduar që secili të marrë sa më shumë nga shpërblimet, parku i Çairit këto ditë të shenjta ka lulëzuar nga gjallëria, mirësia dhe bamirësia.

Të shumtë janë ata që dëshirojnë të marrin shpërblimin e Allahut të Madhërishëm.

Në këtë garë për vepra të mira u aktivizuan shumë njerëz, duke shpresuar në mëshirën e Allahut: *“Kush i jep iftar një agjëruesi, atij i takon shpërblimi njësoj si i agjëruesit, pa iu mangësuar agjëruesit shpërblimi.”* Pikërisht duke u nisur nga ky hadith, si ata që shërbenin dhe ata që hanin iftarin, fytyrat e tyre shkëlqenin nga gëzimi, se janë në mëshirën e Allahut.

“Jam i lumtur që jam i përzgjedhur të shërbej në këtë sofër të madhe. Padyshim se mirësitë e Allahut i dëshiron çdo person, prandaj edhe unë shpresoj në shpërblimet vetëm nga Ai, për këtë vepër që po bëjmë”, thotë Avni Asllani, aktivist.

“Elhamdulillah, i falemenderoj këta të rinj dhe SHQA. “Bamirësia”, që po e shtrojnë këtë sofër, jemi të kënaqur që tre vite me radhë po grumbullohemi në Parkun e Çairit. Shpresoj të vazhdojë kështu sa të jetë jeta”, tha një vizitues.

Prandaj o robër të Allahut, ejani dhe merrni pjesë në garën hyjnore, në garën që askush nuk do të mbetet pa shpërblim, por gjithkush do të shpërblehet. Ejani o njerëz, të ulemi në shtëpinë e madhërishme të Allahut dhe trupin ta mbushim me mëshirë hyjnore.

O Zot të falënderojmë një mijë herë, që na e bërë të mundur edhe një herë tjetër ta shijojmë këtë muaj madhështor dhe plot mëshirë. ■

DISKRIMINIMI

NDAJ “TJETRIT”



Kjo ishte pikënisja nga e cila u nis perëndimi në shkatërrimin e indianëve, filloi luftërat e kryqëzatave kundër botës islame në mesjetë, inicioi inkuizionin kundër muslimanëve dhe hebrejve të Andaluzisë dhe zhduki popuj të tërë në Afrikë, Azi dhe Australi, edhe pse s’kishin asnjë gabim tjetër përpos se ishin “tjetri”, i cili nuk ka të drejtë për të jetuar.

SHKRUAN: BEKIR HALIMI

Mjekja egjiptiane **Merva Sherbini** u vra në korridorin e një gjykate në Gjermani nga dora e një ekstremisti gjerman, për shkak se ajo mbante mbulesën islame, hixhabin. Vrasja e saj u bë në një formë shumë të keqe, duke goditur tetëmbëdhjetë herë me thikë, para të gjithë njerëzve dhe në prani të policisë, e cila ndërhyri vetëm për të plagosur burrin e saj, i cili u mundua t’i vijë në ndihmë gruas së vet. Ky rast i tmerrshëm dhe katastrofal ngacmoi një çështje shumë të ndjeshme dhe

vendimtare, e ajo është “tjetri”, integrimi i tij në shoqëritë ku jeton, sa mund të përputhet ai në shoqërinë ku jeton dhe sa kanë fuqi këto shoqëri të kooperojnë me shtresa që dallojnë prej tyre në komb, racë, fe dhe kulturë. Doli kështu në shesh këndvështrimi perëndimor ndaj tjetrit, por ky rast është edhe një mundësi e mirë për të treguar edhe këndvështrimin islam ndaj tjetrit.

Sidomos tani kur bota islame ballafaqohet me një fushatë të egër nga perëndimi, duke e akuzuar atë se i shtyp pakicat, nuk kanë të drejta ata, madje nuk iu plotësohen as nevojat e tyre elementare.

Edhe pse edhe historia, gjendja e tanishme, por edhe realiteti dëshmojnë se diskriminimi dhe shtypja e tjetrit është prodhim perëndimor dhe trashëgimi e tyre kulturore për shekuj me radhë.

“Tjetri” dhe perëndimi

Tjetri si term është prodhim perëndimor, nuk ka lidhje aspak me shoqëritë dhe kulturën islame, edhe pse kohët e fundit përdoren edhe në botën islame, ashtu siç kanë depërtuar shumë terme, kuptimi i të cilave ka bagazh kulturor perëndimor. Termi “tjetri” ka lindur në Perëndim, kurse para tij ka ekzistuar një term tjetër, i cili edhe ka qenë shkak i krijimit të këtij termi, e ai është termi “unë”. Ky term ka kuptimin e vet perëndimit. Perëndimi e shihte veten si “unë”, i cili mbart të gjitha vlerat, se ishte qendra e gjithësisë dhe origjina e civilizimit, kurse pjesa tjetër e botës ishte e zhveshur nga çdo vlerë dhe mirësi.

Prandaj termi “tjetri” është manifestim i kryelartësisë ndaj të tjerëve, sepse “uni” perëndimor është pika e fillimit dhe këndvështrimi për të kuptuar raportin e perëndimit me tjetrin dhe vlerësimin e tij ndaj tjetrit. Prodhimet e kulturës perëndimore janë plot me fakte, që tregojnë kryelartësinë e perëndimit ndaj tjetrit dhe nënçmimin e tjetrit në çdo aspekt. Kështu që raporti mes “unit” dhe “tjetrit” u shndërrua në raport mes zotërisë dhe skllavit, të mirit dhe të keqit, të ndershmit dhe të poshtrit, të dijshtit dhe injorantit, të civilizuarit dhe barbarit.

P.sh. Aristoteli thotë se “tjetri” është i huaji, kurse letrarët dhe filozofët e tjerë “tjetrin” e konsiderojnë si njeri jo të natyrshëm, ose armik, ose djall, ose barbar, ose rrezik vdekjeprurës, ose të keq, ose i huaji, i dyshimti, dhe krejt në fund “tjetri” është terroristi, të cilin duhet ta fshijmë nga

“...Edhe historia, gjendja e tanishme, por edhe realiteti dëshmojnë se diskriminimi dhe shtypja e tjetrit është prodhim perëndimor dhe trashëgimi e tyre kulturore për shekuj me radhë...”

faqja e dheut. Këto botëkuptime raciste dhe mendjemëdha janë ato që e kanë shtyrë **Monteskienë**, që të tallat me krijesat e zeza, duke thënë:

“Zoti, i cili ka urtësi të madhe, nuk ka mundësi të ketë vendosur shpirt ose thënë më mirë shpirt të mirë në trupin e njeriut të zi”.

Kurse **Renani** ka thënë: “Vetëm një racë lind zotërinj dhe heronj, e ajo është raca evropiane. Kjo racë nëse bie në nivelin e ahureve ku punojnë të zinjët dhe kinezët, revoltohet dhe hidhërohet”.

Nazistët gjerman e shohin veten si soji më i mirë, kurse të tjerët soji i skllëverve, prandaj Hitleri edhe e çoi njerëzimin në një luftë botërore, ku shkuan viktimë me miliona njerëz, krejt kjo me qëllimin e dominimit të botës nga raca ariane.

Filozofët bashkëkohorë perëndimorë janë munduar ta ambalazhojnë këtë hegjemoni dhe mendjemadhësi ndaj “tjetrit” me ambalazhin e epërsisë shkencore dhe hulumtimeve akademike. **Molimbahu** p.sh. themeloi teorinë e tij të njohur, se epërsia shkencore është përputhja mes gjenialitetit dhe natyrës së mendjes evropiane. Të tjerët që kanë ardhur pas tij kanë vazhduar në të njëjtën formë të hulumtojnë arsyetimet shkencore për

epërsinë dhe dominimin ndaj “tjetrit” dhe forcimin e “unit”. Ky botëkuptim mendjemadh e ka formësuar mendjen perëndimorit, mënyrën e të menduarit dhe të sjelljes ndaj tjetrit. Kjo ishte pikënisja nga e cila u nis perëndimi në shkatërrimin e indianëve, filloi luftërat e kryqëzatave kundër botës islame në mesjetë, inicioi inkuizionin kundër muslimanëve dhe hebrenjve të Andaluzisë dhe zhduki popuj të tërë në Afrikë, Azi dhe Australi, edhe pse s’kishin asnjë gabim tjetër përpos se ishin “tjetri”, i cili nuk ka të drejtë për të jetuar.

Këtë rrugë e kanë vazhduar edhe hebrenjtë e sotshëm, saqë **Menahem Begini** pas masakrës në **Sabra** dhe **Shatila** u shpreh në parlamentin izraelit, se palestinezët e vrarë aty nuk janë gjë tjetër veçse kafshë që ecin me dy këmbë dhe se nuk e meritojnë të jetojnë. Duke u nisur nga kjo trashëgimi raciste e botëkuptimit perëndimor karshi “tjetrit”, edhe myslimanët që jetojnë në shoqërinë perëndimore vuajnë nga shtypjet e njëpasnjëshme dhe mungesën e të drejtave esenciale dhe orvatjes ndaj tyre për fshirjen e identitetit, madje edhe në shtetet që krenohen me demokraci, liri dhe barazi. Ata u munduan t’ua detyrojnë kulturën perëndimore myslimanëve, detyrimi për të jetuar në mënyrë perëndimore, ndalimi i myslimanëve në shumë raste për të zhvilluar ritualet fetare në mënyrë të lirë, madje edhe kanë ndaluar ndërtimin e xhamive dhe ngritjen e ezanit në shumë vende të perëndimit edhe sot.

Premtimet dhe shpresat e lirisë, barazisë dhe vëllazërisë njerëzore shkuan huq, kurse myslimanët në shoqëritë perëndimore llogariten si njerëz të kategorisë së tretë apo të katërt, ose e thënë më qartë, pa të drejta të vërteta.

Mos të mendojë dikush se kjo hegjemoni dhe mendjemadhësi e perëndimit në sjelljen e tij ndaj “tjetrit” ka ndryshuar ose dallon

në shekullin tonë. Madje është shkujdesje dhe injorancë e rëndë supozimi i paanshmërisë dhe i drejtësisë në sjelljen e perëndimit ndaj “tjetrit”. Përndryshe si do të arsyetojmë sulmet e egra dhe barbare të perëndimit dhe civilizimit të lartë, siç u pëlqen atyre të vetëquhen në botën islame. Për çfarë mëkati u vranë miliona të pafajshëm në Palestinë, Irak, Afganistan, Bosnje, Çeçeni, Tajlandë, Filipine, Turkmenistanin Lindor etj?! Cili është arsyetimi logjik, politik apo shoqëror, i cili mund t’i arsyetojë këto masakra ndaj të pafajshmëve, fëmijë, gra ose pleq. Pastaj mund të shikoni justifikimet e dobëta, të cilat po ofron perëndimi për të arsyetuar këto sulme, të cilave vetëm njerëzit e marrë, të poshtëruar dhe tradhtarë u besojnë.

Shikoni drejtësinë perëndimore, se si vepron me kriminelët në rastin e burgut Ebu Graib, ose atë që përdhunoi vajzën dhe e vrau atë dhe tërë familjen e saj në mënyrë më të egër. Shikoni dënimet e lehta që marrin ata për krimet e rënda, që kanë bërë ndaj “tjetrit”, atëherë do ta kuptojë kushdo natyrën e drejtësisë perëndimore. Shikoni policinë gjermane, e cila i shkrep plumbat ndaj burrit të mjekes së sulmuar, duke menduar se arabi është “tjetri” dhe se ai është kriminel dhe terroristi. Shikoni se si bastisën shtëpinë e mjekes, duke kërkuar argumente për ta llogaritur si anëtare të ndonjë grupi terrorist për të arsyetuar kriminelin, që e kishte therur me thikë. Policia gjermane i mori mus’hafin që lexonte mjekja e vrarë për ta sjellë si argument, se ajo është terroriste. Pastaj shikoni se si veproji media gjermane në lidhje me këtë çështje, nuk i bëri jehonë aspak, deri sa u organizuan protesta anembanë botës islame, po ashtu edhe në Gjermani. E thënë shkurtimisht argumentet janë të shumta, që flasin për mentalitetin racist dhe armiqësor, që

dominon në jetën perëndimore edhe sot në sjelljen e tyre ndaj “tjetrit”, për të cilin shkrimtari i njohur anglez, **Eduard Albi** ka thënë: “‘tjetri’ është ferr!”

“Tjetri” në botën Islame

Në Botën Islame nuk ekziston termi “tjetri”. As në literaturën e as në trashëgiminë tonë kulturore nuk ka fakte që të tregojë, se ekziston një term i tillë. Mbarë trashëgimia islame është e boshatisur tamam nga shprehja “tjetri”, qoftë si shprehje apo si kuptim. Mund ta përjashtojmë fanatizmin fisnor, i cili ka qenë i fuqishëm para ardhjes së fesë Islame tek arabët, fanatizëm që herë pas here del në shesh në historinë islame, mirëpo ky fanatizëm nuk i drejtohet jomyslimanëve, por edhe vetë myslimanëve, sepse janë trazira që burojnë nga fanatizmi fisnor e jo për shkak të fesë, ngjyrës apo gjuhës.

Në Botën Islame nuk ka vend për termin “tjetri”, as në jetën shoqërore, as në jetën kulturore, por ka terme të cilat i ka rregulluar sheriati islam, i cili rregullon raportet mes myslimanëve dhe jomyslimanëve. Këto terme i personifikojnë shumë qartë këto raporte, drejtësinë dhe dëlirësinë islame. Këto terme janë: Ehli Dhime (njerëzit e garantuar), Ithtarët e Librit, kundërshtarët, ithtarët e epshit etj. Të gjitha këto terme nuk kanë lidhje me nacionalizëm, racizëm, ngjyrë apo gjuhë. Por janë terme që tregojnë kush i kundërshton myslimanët në besim brenda shoqërisë myslimane, të cilëve Allahu, i cili është Ligjvënësi i Urtë, u ka caktuar të drejta dhe detyrime, që përputhen me pozitën e tyre si pakica të nderuara brenda shoqërisë myslimane. Madje sheriati të drejtat e këtyre pakicave i ka madhëruar shumë e argumentet që flasin për këtë fakt janë aq shumë, saqë nuk arrijmë t’i përmendim në këtë shkrim. Vendi i tyre është në librat e

fikhut dhe shariatit, kush dëshiron që të njihet me to le t’i shfletojë ato libra.

Nën hijen e kësaj mendje islame, e cila buron nga sheriati i pastër kanë gëzuar Ehli Dhimitë, apo Ehli Kitabët shumë të drejta dhe veçori, të cilat sot myslimanët në perëndim nuk mund t’i gëzojnë as një për qind. Ata kanë fituar aso të drejtash nën hijen e qeverisjes islame, saqë s’kanë mundur t’i fitojnë as gjatë qeverisjes së tyre mes vete, sikurse ka ndodhur me hebrenjtë pas rënies së Andaluzisë, ajo që ndodhi me banorët e Kostandinopojës pas çlirimit nga sulltani Muhamed Fatihu. Jomyslimanët në shoqëritë myslimane kanë fituar aso të drejtash dhe veçorish, të cilat janë bërë shkak për mendjemadhësi dhe për t’u bërë bukëshkalë. Me plot siguri dhe paanshmëri mund të themi se pakicat jomyslimane brenda shoqërive myslimane në disa raste janë më të lumtur se vetë myslimanët në ato vende.

Si përmbledhje mund të themi se çështja e “tjetrit” është një çështje me origjinë perëndimore, me të kanë synuar arsyetimin e sulmeve kundrejt botës islame, shkeljen e të drejtave të pakicave myslimane të përhapura në mbarë botën, të cilat veprojnë me plot entuziazëm dhe efektivitet në ato shoqëri, gjëra që shkaktuan përhapjen e Fesë Islame në perëndim. Prandaj edhe u ngritën zëra prej vendeve të ndryshme për detyrimin e dëbimit të myslimanëve nga perëndimi, që mos ta kaplojë Islami të tërë botën. Por ajo që nuk e dinë këta ziliqarë dhe fanatikë është fakti se e drejta, humanizmi, parimet dhe ndjekja me besnikëri e mësimave të Zotit e bëjnë një popull apo racë mbizotëruese, e jo padrejtësia, nihilizmi dhe agresiviteti!! ■

JA SI LEXOHEM LIBRAT

Kjo temë është shumë e rëndësishme për ata që lexojnë, në mënyrë që të mos na kalojë jeta e më në fund të kuptojmë se shumë pak ose aspak s'kemi përfituar.

SHKRUAN: AGIM BEKIRI

Këshilla e parë: duhet të jemi të vetëdijshëm për vlerën e kohës.

Ditët që na kalojnë janë pjesë e jetës sonë. Nuk mund të paramendohet një nxënës dije, i cili nuk kujdeset për kohën e vet. Shumë njerëz, gjënë më të lirë kanë kohën e tyre, prandaj nderojat, pushimet dhe piknikët i bëjnë pa plane dhe të gjata. Nëse je koprrac për kohën tënde, për shkak të

leximit, dije se je në rrugë të vërtetë. Kush e vështron me kujdes gjendjen e dijetarëve të vjetër vëren se arrijtet e tyre ishin për shkak të koprracisë që kishin për kohën e tyre. Ibën Xheuzi në librin e tij, që tani e kemi edhe në gjuhën shqipe “Gjuetia e meditimeve” thotë: “Nëse ju them se gjatë kërkimit të diturisë kam lexuar njëzet mijë vëllime ndoshta do të ishte pak”.

E gjithë kjo literaturë nuk mund të lexohet nga njerëz që janë shumë bujar për kohën e tyre. Ibën Xherir Taberiu kur deshi



të shkruajë “Historinë Islame” dhe “Tefsirin” kërkoi prej nxënësve të tij t’i sjellin tridhjetë mijë fletë. Ata i thanë: O imam, këtë s’mund ta mbajnë as devetë! Allahut i kërkojmë ndihmë, qenkan shuar ambiciet- u tha ai.

Kishte edhe prej tyre që ndonjëherë i linin adhurimet vullnetare, duke u marrë me lexim siç është rasti i Ibën Dekik Idit, i cili kur dëgjoji se shitet libri “Sherh el Kebir” e bleu atë tre mijë dërhem dhe u mbyll që ta lexojë dhe kryente vetëm farzet.

Tani njerëzit kanë shumë kohë. Gjeneratat e para edhe në shtratin e vdekjes e shfrytëzonin kohën për të mësuar. Është tejet interesant rasti i Ibën Xheririt, i cili duke qenë në shtratin e vdekjes dëgjoji njërin pranë tij duke u lutur: “O Allah që s’ke fillim, që dëgjon çdo zë, që eshtrat i vesh me mish pas vdekjes...” Ibën Xheriri e pyeti: Kush e ka thënë këtë lutje? Transmetohet nga Xhafer ibën Muhamedi, i tha ai. E thirri birin e tij dhe i kërkoi një fletë dhe e shkroi këtë lutje. Të pranishmit i thanë: O imam, nuk je në gjendje tani të shkruash! Ua ktheu: Kam frikë të takoj Allahun pa e ditur këtë lutje. Kemi edhe shembullin e Ibën bazit dhe Uthejminit, të cilët gjatë rrugëtive të tyre për në xhami ose ndokund më larg e kalonin të tërë kohën në lexim ose përsëritje.

Këshilla e dytë: Mos kalo te librat për të cilët ende nuk je i aftë për t’i lexuar, ngase hyrja në atë literaturë mund të të bezdisi dhe si pasojë të braktisësh leximin.

Do të sjellim një shembull për këtë: një nxënës fillon të lexojë fetva. S’ka dyshim se leximi i fetvave është tërheqës. Unë njoh shumë nxënës dije, të cilët patën filluar leximin e fetvave të Ibën Tejmijes dhe duke lexuar kalojnë një kapitull dhe e kuptojnë, vjen një tjetër nuk e kupton, një tjetër e kupton gabimisht. Pastaj kalon në ndonjë

“Shumë njerëz bëjnë gabime, kur u përshkruajnë disa dijetarëve fetva, të cilat ata nuk i kanë dhënë. Shkaku është leximi i shpejtë...”

libër tjetër duke menduar se problemi është tek libri. E vërteta është se problemi qëndron tek ai, sepse nuk e ka respektuar shkallëzimin në studim. Është një rast shumë domethënës që ka ndodhur me imam Ahmedin. Vjen një njeri tek ai dhe e pyet: A mund të pastrohemi me ujë, i cili ka aromë trëndafili? Imam Ahmedi i tha: Nuk e preferoj një gjë të tillë. Ai i bëri edhe disa pyetje të ngjashme dhe imami i dha të njëjtën përgjigje. Kur përfundoi pyetësi dhe desh të ngrihet e të shkojë, imam Ahmedi iu afrua dhe i tha: A e di se ç’duhet thënë kur të hysh në xhami? Jo, u përgjigj ai. Po kur të dalësh prej xhamisë, e pyeti sërish imami? Tha: Jo.- Atëherë shko dhe mësoi këto gjëra,- e këshilloi imam Ahmedi.

Ka disa parapërgatitje që nuk duhet t’i anashkalojmë gjatë kërkimit të diturisë. Nuk duhet që të kalojmë në çështje të mëdha para se t’i mësojmë ato të voglat.

Këshilla e tretë: Mos kalo prej leximit të një libri të rëndë në një libër tjetër, i cili po ashtu është i rëndë për ta kuptuar dhe ka nevojë për sqarime, ngase kjo gjë të lodh trurin dhe të bezdis. Nëse lexon një shkrim ose libër, që ka nevojë për përqendrim të madh dhe për sqarime, për leximin e radhës zgjidh diçka më të lehtë, që të jetë një lloj pushimi për trurin tënd. Shumë njerëz duke mos respektuar këtë rregull marrin një libër të rëndë për të lexuar, pastaj një tjetër, më pas edhe një tjetër dhe kështu mendojnë, se nuk janë për të nxënë dituri

dhe si pasojë e braktisin leximin.

Këshilla e katërt: Kujdes nga leximi i shpejtë.

Është përhapur në këto kohë metoda e leximit të shpejtë dhe për këtë gjë organizohen seminare. Ky lloj leximi nuk është i dobishëm për nxënien e diturive fetare, të cilat kërkojnë një përqendrim të madh gjatë leximit të librave bazë. Shumë njerëz bëjnë gabime, kur u përshkruajnë disa dijetarëve fetva, të cilat ata nuk i kanë dhënë. Shkaku është leximi i shpejtë. Pa u thelluar dhe pa përsëritur leximin e këtyre librave nuk mundet që të formosh një pasqyrë reale për çështjen që po studion. Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e kishte zakon që fjalët t'i përsëriste nga tre herë, në mënyrë që dëgjuesit ta kuptojnë. Ejub Sihtijani kur pyetej për ndonjë çështje i thoshte pyetësit: Ma përsërit pyetjen! Nëse pyetësi e përsëriste pyetjen njësoj si herën e parë, ai i përgjigjej, e nëse e ndryshonte pyetjen, ai nuk i përgjigjej, sepse siç thoshte ai: Kush nuk e mban mend pyetjen, si mundet që të mbajë mend përgjigjen?!

Këshilla e pestë: Përsëritja e librit.

Prej gabimeve që bëhen në këtë kohë është se nëse e lexojnë një libër nuk i kthehen më për së dyti për ta lexuar. Metodologjia e dijetarëve të vjetër ishte përsëritja e leximit të librave. Muzeniu, nxënësi i imam Shafiut pesëdhjetë vjet ka lexuar librin “Risale”. Disa dijetarë e kanë lexuar “Sahih Buharin” gjashtëdhjetë herë. Gjatë leximit të një libri për së dyti do të kuptosh më shumë dhe më mirë se nga hera e parë.

Këshilla e gjashtë: Kujdes nga lakmia për t’u njohur se lexon.

Abdullah ibën Mubareku thotë: Nuk ka devotshmëri tek ai që kërkon emër e famë. Po, duhet të flasim dhe t’ju bëjmë dobi njerëzve në bazë të asaj që kemi lexuar,

mirëpo nuk duhet që t’i mashtrojmë të tjerët, se gjoja kemi arritur një shkallë diturie, që në fakt nuk e kemi arritur. Kjo është e dëmshme për të. Imam Ahmedi thoshte: Do të doja të jem në një prej kodrave të Mekës dhe të mos njihesha.

Ata njerëz nuk e donin famën, sepse e dinin se është e dëmshme. Omeri, radiajllahu anhu, kur pa se pas Ubejit shkonin njerëzit, e qortoi atë.

Këshilla e shtatë: Nënvizimi i dobive dhe i njoftimeve të rralla që do të mësohesh gjatë leximit të një libri.

Kjo metodologji është shumë e dobishme, sepse njoftimet harrohen, kurse nëse nënvizohen apo mbahen shënime veçan është më e lehtë për t’u përsëritur. Gati çdo dijetar e bën një punë të tillë. Kemi rastin e Ibën Kajimit, që ka shkruar librin “Fevaid” (Dobitë), pastaj shejh Uthejminin me librin “Feraidul Fevaid” (Dobitë e rralla).

Këshilla e tetë: Leximi kolektiv.

Preferohet që bashkë me moshatarët e tu të lexosh dhe të diskutosh. Zgjidhet një libër, i cili është paksa i vështirë, në mënyrë që të zhvillohen debate dhe të bëhen shtjellime, dhe të arrihet deri te një kuptim i shëndoshë. Nëse haset në ndonjë çështje që ju s’mund ta kuptoni, atëherë kthehuni te dijetari.

Këshilla e nëntë: Leximi të mos bëhet në llogari të prezencës nëpër ligjërata.

S’ka dyshim se leximi është i dobishëm, mirëpo mos mendo se dobia është më e madhe edhe në krahasim me prezantimin në ligjërata. Gjatë ligjëratave angazhohen shumë mendje, kurse gjatë leximit tënd je vetëm ti, prandaj parafytyrimi më i saktë i çështjeve është nëpër ligjërata, sepse aty bëhen pyetje, debate, diskutime e të tjera. ■



Feja Islame është dije e gjerë që ndër vete ngërthen shumë shkencë, ndër to: gjuha arabe, usulul fikh, usulu tefsir, mustalahul hadith dhe texhvidi. Pa njohjen e tyre askush nuk mund të quhet njohës i Islamit apo hoxhë i mirëfilltë

SHKRUAN: OMER BERISHA

Të përcjellësh gjërat e mira nga një popull te një tjetër, nga një gjuhë në gjuhë tjetër është kontribut që vlen të falënderohet nga të gjithë njerëzit, meqë Allahu i krijoi njerëzit në atë mënyrë që të kenë nevojë për njëri-tjetrin dhe të përfitojnë nga përvojat e ndryshme. Mirëpo ai përfitim shpeshherë mbetet i pamundshëm, sepse jo çdoherë njeriu zotëron mjetin për të kuptuar përvojat e të tjerëve. Së këndejmi del në pah nevoja për përkthyes, që janë ekspertë në lëmit përkatëse, të cilët kanë mundësi të përcjellin shkencat, përvojat dhe idetë përkatëse tek një popull tjetër.

Në këtë shkrim modest do t'i qasem përkthimit të teksteve me përmbajtje fetare dhe dua të theksoj se njohja e gjuhëve (nga e cila dhe në të cilën përkthen) nuk është kushti i vetëm për të përkthyer një tekst, siç përmend Edmond Tupja, Mira Meksi dhe

ekspertë të tjerë.

Feja Islame është dije e gjerë që ndër vete ngërthen shumë shkencë, ndër to: gjuha arabe, usulul fikh, usulu tefsir, mustalahul hadith dhe texhvidi. Pa njohjen e tyre askush nuk mund të quhet njohës i Islamit apo hoxhë i mirëfilltë. Kësisoj ai që e njuh gjuhën arabe nuk do të thotë se është i aftë të bëjë një përkthim të shëndoshë me tematikë fetare. Kjo i ngjan shembullit tim, nëse unë shpreh gatishmërinë të përkthej nga arabishtja një tekst nga lëmi i astronomisë apo mjekësisë. Po ju them se këto ditë i bëra ca prova të përkthej diçka nga mjekësia dhe më dolën fjali të pakuptimta ose me kuptim çfarë unë dua, por me siguri jo ato që do autori.

Këto gjëra që po përmend deri këtu janë një fenomen mjaft i përhapur ndër shqiptarët. Ndërsa fenomeni më i çuditshëm është përkthimi i librave fetarë, nga njerëz që – elhamdu lillah – e falin namazin dhe janë besimtarë praktikantë, por mendojnë se kjo

“Le të gjejnë përkthyes profesionalë e të përkthejnë nga gjuha origjinale e librit, edhe nëse do të paguajnë diçka më tepër, sepse dija është më e shtrenjtë sesa qesja me euro...”

mjafton si përgatitje e denjë për të përkthyer libra fetarë, vetëm me qëllimin që të japin kontributin e tyre për këtë fe madhështore, ndaj pa një pa dy, vendosin të marrin një libër nga gjuha angleze apo boshnjake i përkthyer nga arabishtja dhe ia ofrojnë lexuesit shqiptar në gjuhën shqipe. Kjo është gjendja e qëllimmirëve, ndërsa ata që përkthejnë, madje themelojnë shtëpi botuese vetëm e vetëm për t'i shtuar titujt në raftin e realizimeve, në mënyrë që të rrisin përfitimet materiale, ata bëjnë krim ndaj Islamit dhe mashtrim ndaj muslimanëve shqiptarë. Unë i përkujtoj ata, që nëse duan të bëjnë një punë të mirëfilltë le të gjejnë përkthyes profesionalë e të përkthejnë nga gjuha origjinale e librit, edhe nëse do të paguajnë diçka më tepër, sepse dija është më e shtrenjtë sesa qesja me euro. Nëse nuk e bëjnë këtë, atëherë le të gjejnë një profesionist që do të bëjë recensimin e librit, i cili do ta krahasojë me origjinalin dhe do ta lexojë librin nga fillimi deri në fund.

Ritheksoj se Islami është dije e gjerë dhe nuk mund të përfaqësohet nga gjithsecili, sepse gabimet që po bëhen do të kenë efekte negative tek njerëzit në përgjithësi. Allahu thotë: **“Mos shko pas diçkaje për të cilën nuk ke dijeni. Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjithë këta do të merren në përgjegjësi”**. (Isra 36).

Ky shkrim nuk duhet të kuptohet si tendencë për të monopolizuar përkthimet e librave fetarë, por si tendencë për t'u ngritur

sa më lartë si besimtarë, të cilët kur bëjnë një punë e përkryejnë atë dhe për t'i ofruar popullit tonë dije të pastër dhe të sigurt, përndryshe do t'i shkaktojmë kokëçarje pasardhësve tanë. Për t'i vërtetuar sadopak fjalët e sipërpërmendura mora t'i shfletoj disa libra të përkthyer në gjuhën shqipe dhe krejt rastësisht gjeta disa gabime. Disa nga ato libra janë të përkthyer nga arabishtja, por jo nga njerëz profesionistë dhe të tjera nga gjuha angleze apo boshnjake. Nga ato po sjell këta shembuj:

1. **“Sahihul Buhari”** (Prishtinë, 2002), vëll. 9 fq. 115. Hadithi nr. 3829 është:

“Na ka treguar Mahmudi...”

Kur e ndërtonin Qaben Pejgamberi s.a.v.s. dhe Abbasi bartnin gurët. Atëherë Abbasi Pejgamberit s.a.v.s. i tha: “Vëre shaminë tënde mbi supet të të mbrojtë nga gurët”. Ai u ul në tokë, i drejtoi sytë e vet kah qielli dhe filloi të lutet:

“Shaminë time, shaminë time. Shamia e shtrëngoi atë”.

Paqartësia për lexuesin: Pse qenka ulur në tokë, çfarë lutje paska bërë, a paska bartur shami Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem?!!*

Përkthimi i drejtë do të ishte: “Na ka treguar Mahmudi...”

Kur po ndërtohej Qabeja, Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*, me Abasin bartnin gurë. Atëherë Abasi i tha Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*: Vendose izarin (veshjen e poshtme) mbi qafë të të ruajtë nga gurët. (Kur e hoqi izarin dhe iu zbulua aureti) Ai ra përtokë dhe sytë i drejtoi nga qielli. Kur erdhi në vete bërtiste: Izarin tim, izarin tim dhe pastaj e lidhi mirë izarin.

Shkaku i gabimit: Jo-referimi te librat bazë që komentojnë hadithet e Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem* fjalë për fjalë.

2. **“Parime në dashuri”** nga shejhulislam Ibën Tejmije (Klubi Studentor, 2009); fq. 224. Në paragrafin e tretë qëndron:

Sa i përket kadasë dhe kaderit, ajo është dituria e Allahut dhe Libri i Tij dhe ajo që

përputhet me të prej vullnetit dhe krijimit të Tij. Kadaja dhe kaderi marrin parasysh të vërtetën që është shtyrë...

Paqartësia për lexuesin: Për cilin Libër bëhet fjalë, Kuranin apo librat e mëhershme? Çfarë është kjo e vërtetë e shtyrë?

Përkthimi i drejtë do të ishte: Kadaja dhe kaderi është dituria e Allahut dhe e shkruara e Tij, së cilës i pasojnë vullneti dhe krijimi i Tij. Kadaja dhe kaderi janë realiteti i asaj që vijon...

Shkaku i gabimit: Mosnjohja e çështjes së kaderit, sepse gjatë shpjegimit të çështjes së kaderit në arabisht, kur përmendet fjala “kitab” nuk nënkupton librin zakonisht, por ka tamam kuptimin gjuhësor: “e shkruar” d.m.th. atë që e shkroi lapsi me urdhër nga Allahu, që para se t’i krijojë krijesat tjera.

I njëjti gabim përsëritet edhe dy herë tjera në të njëjtën faqe.

3. “Esenca e dispozitave të legjislacionit Islam” nga Abdulgani el Makdisi; (Essebil, viti i botimit: ?) fq. 183. Hadithi nr. 340 është:

...Nga Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmetohet se: “Një çifut vrau një robër-eshë me disa stoli prej argjendi dhe i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) urdhëroi që ai të vritej po me to.

Paqartësia për lexuesin: A thua çfarë stoli vrasëse paskan qenë ato? A qenka pjesë e kisasis që vrasësi të vritet me të njëjtin mjet që ka vrarë?

Përkthimi i drejtë do të ishte: nga Enesi, ndërsa ky përcjell se një çifut kishte vrarë një vajzë për shkak të disa stolive prej argjendi dhe Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, zbatoi kisasin mbi të.

Shkaku i gabimit: Jo-referimi te librat bazë që komentojnë hadithet e Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem* fjalë për fjalë.

4. “Sahihul Buhari” (Dibër, 2002), vëll. 10 fq. 330-331, Hadithi nr. 4452, 4453 është:

...se Eba Bekri r.a. i hypur në kalë u nis nga shtëpia e tij prej es Sunhi. Zbriti nga kali, hyri

në xhami dhe pa i folur askujt hyri te Aisheja, i dha tejemmum Resulullahit s.a.v.s. i cili ishte në agoni dhe i mbuluar me tesha. Ia shpalosi fytyrën pastaj e mori në krah e puthi dhe filloi të qajë, pastaj tha:

“Pasha babën dhe nënën time, pasha Allahun, Allahu nuk do t’i bashkojë dy vdekje, ndërkaq vdekjen të cilën ta ka shtruar ti vërtetë ke vdekur”.

Paqartësia për lexuesin: Për çfarë agonie flitet ndërsa në fund të hadithit thotë: “ti vërtetë ke vdekur”? Gjithashtu, mos vallë ka ndonjë sevap tejemumi pas vdekjes? Më e rëndësishmja: Si ka mundësi Ebu Bekri, radijallahu anhu, të bëjë kësi gabimi, të betohet në dikë tjetër pos Allahut? A nuk e ka ditur ai hadithin e më të dashurit të tij: “*Ai që betohet në dikë tjetër pos Allahut ka bërë kufër apo shirk*”?

Përkthimi i drejtë do të ishte: ...se Ebu Bekri, radijallahu anhu, nga shtëpia e tij në Sunh erdhi me kalë dhe kur zbriti, hyri në xhami dhe pa i folur askujt hyri te Aisha, radijallahu anha, dhe iu afrua Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i cili ishte i mbuluar me rrobën Hibere (një rrobë e shtrenjtë dhe e qëndisur). Ia zbuloi fytyrën, pastaj e përqafoi, e puthi dhe qau, e pastaj tha:

“Sakrifikofsha babën dhe nënën time për ty, pasha Allahun, Ai nuk do t’i bëjë dy vdekje për ty, ndërsa vdekja që ishte e shkruar për ty, ti tashmë ke vdekur”.

Shkaku i gabimit: Mosnjohja e çështjeve të teuhidit dhe jo-referimi te librat bazë që komentojnë hadithet e Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem* fjalë për fjalë.

Këtu solla vetëm katër shembuj dhe duke dashur të mos zgjatem dua të ritheksoj se çështja është me rëndësi. Ajo nuk duhet të anashkalohet, pasi libri për shumë njerëz është i vetmi këshillues dhe udhëzues. Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “*Çdo bir i Ademit gabon, më i miri nga ata është ai që pendohet*”. ■

VETËVRASJA - ANOMALI QË KA ZGJIDHJE

Ka pasur shumë iniciativa për t'ua mësuar nxënësve dhe qytetarëve të tjerë (kryesisht të moshës rinore) përdorimin e prezervativëve në emër të mbrojtjes nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme, por për çudi mungon iniciativa për t'ua mësuar atyre se cilat janë rrugët që çojnë në infektimin me mendimin për vetëvrasje



SHKRUAN: IMER PANTINA

Vetëvrasja! Pëshpëritje më e ftohtë se akulli dhe dramë që e tejkalon shumëfish fjalën vrasje. Këtu elementi i vrasjes merr përmasa aq trishtuese, ndjell aq shumë frikë nga jeta, sa të lë përshtypjen se ata që vrapojnë drejt kësaj vepre i kanë ngarkuar mendjet e tyre me të gjitha fatkeqësitë e botës. Toka e Allahut të Madhërishëm është shumë e gjerë, me mrekulli të panumërta, madje me rrugë të shumëllojshme njerëzore.

Megjithatë aty ka ide të kundërta me krijimin e Zotit Mëshirues dhe kemi të tillë që zgjedhin formën më të vrazhdë të dhunës. Madje atë të dhunës ndaj vetvetes. Kjo dhunë reflekton “kujdesin” më të mbrapshtë që njeriu ka ndaj vetes. Duke mos qenë në gjendje për t’u përballur me jetën, rrethin social e kulturor, persona të caktuar dorëzohen dhe marrin vendimin më të keq, atë të vrasjes së jetës së tyre.

Litarë të shtrënguar në fyt, kimikate, hedhje nga katet e larta të ndërtesave etj., janë vetëm disa nga risitë që po ndodhin në

Kosovën e pasluftës. Ndoshta, e përsëris ndoshta të tilla raste ka pasur edhe më herët, por besoj se prej të gjithëve është fakt i pranueshëm, se vetëm pas luftës shifrat e kësaj dukurie janë rritur aq shumë sa për të alarmuar shoqërinë. Gjatë gjashtëmuajorit të vitit 2009, sipas raportit të policisë janë shënuar rreth 37 raste vetëvrasjesh. Mjafton kjo shifër për t'u zgjuar dhe të përpiqemi ta ndalim këtë makineri mendimesh, që sjell vendime fatale. Pak vite më parë i mbijetuan dhunës dhe barbarisë sllave, por edhe në një gjendje të tillë fenomeni i vetëvrasjes as që ishte temë diskutimi. E sot?! A është jeta kaq e zyrtë sa ishte në kohën e pushtimit?! Sigurisht që jo.

Duke qenë indiferent nuk do ta zbehim popullaritetin e kësaj sëmundje.

Fenomeni vetëvrasje është popullor në shumë vende të botës, madje edhe në ato me standarde mjaft të zhvilluara ekonomike dhe sociale. Përmes teknologjisë informative shohim se kjo dukuri nuk ka prekur vetëm të varfrit, të cilët duke shpresuar që të largohen nga jeta e vështirë marrin këtë vendim, por vetëvrasja ka prekur shumë njerëz të klasave të ndryshme shoqërore. Kështu, në këtë mes kemi të varfër, të pasur, intelektualë e analfabetë, politikanë e biznesmenë, madje, familjarë presidentësh dhe udhëheqës me peshë në sferën ndërkombëtare. Edhe tek ne në Kosovë kjo sëmundje e urryer për çdo vit po na rri aktive, si një njollë e turpshme që e ngarkon më tej barrën e rëndë të fenomeneve negative të shoqërisë sonë. Herë me vrull e herë me qetësi tinëzare, e paparashikueshme si gjithnjë, kjo dukuri po godet pa pyetur institucione dhe grupe shoqërore për ta gjykuar. Ende jemi indiferent ndaj saj dhe ende, si për shumëçka tjetër kemi vetëm fjalë boshe.

Le t'i pyesim një herë vetët tona: A mund ta ndalim këtë dukuri, apo duhet të

“Mjafton që të bëhet një hulumtim i njerëzve që frekuentojnë xhamitë tona, këtu në Kosovë, atëherë do të bindemi se morali dhe mësimi që kanë marrë aty, pothuajse e ka çrrënjësuar plotësisht fenomenin e vetëvrasjes për frekuentuesit e vet...”

mjaftohemi me dhënien e ngushëllimeve familjeve që kanë humbur të dashurit e tyre nga kjo?! Në shkolla, medie dhe institucione të tjera publike ka pasur shumë iniciativa për t'ua mësuar nxënësve dhe qytetarëve të tjerë (kryesisht të moshës rinore) përdorimin e prezervativëve në emër të mbrojtjes nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme, por për çudi mungon iniciativa për t'u mësuar atyre se cilat janë rrugët që çojnë në infektimin me mendimin për vetëvrasje dhe cilat janë metodat për t'i dhënë perspektivë jetës, edhe nëse përballemi me sprova të vështira. Si mësimdhënës i shkollës së mesme, ndoshta i shtyrë nga puna e përditshme me gjimnazistë, mendoj se pikërisht në shkollë mund të “injektohet” një ilaç shumë i suksesshëm i kësaj sëmundjeje. Unë dhe kolegët e mi, që të gjithë me shqetësim të madh kemi përjetuar lajme për vetëvrasjet nga mesitë e nxënësve të shkollës ku jap mësim (nuk e shoh të arsyeshme të jap këtu detaje të hollësishme për hir të mirëkuptimit njerëzor), por asnjëri nga ne nuk dha ndonjë kontribut të veçantë që një gjë e tillë të mos përsëritet më. E sa për institucionet vështirë se edhe për disa vite

mund të pritet që të bëjnë diçka.

Shërimi i vetëvrasjes ekziston në mesin e popullit tonë

Përderisa ky fenomen ka depërtuar në shumë shtresa shoqërore, si sëmundje e shumë vendeve dhe e shumë qytetërimeve, mendoj se është plotësisht e arsyeshme për të kërkuar ndonjë vend, ndonjë grup shoqëror në të cilin ky fenomen e ka lënë të painfektuar. Këtu shtroj pyetjen: A kemi ndonjë institucion rregullues që këtë fenomen shkatërrues e ka larguar nga frekuentuesit e vet? Dhe me plot përgjegjësi përgjigjem: PO. Dhe përgjigjes sime ia shtoj edhe ftesën e verifikimit se sa është e vërtetë kjo gjë. Me po-në time, natyrisht se nuk dua ta luaj rolin e një heroi zbulimesh. Jo, sepse një zbulim i tillë ekziston në mesin tonë, qëkurse populli ynë e ka përqaftuar fenë e Allahut Fuqiplotë. Gjendet në mesin tonë dhe gjendet tek ne. Por jo të gjithë shërohen me të. I Dërguari i Allahut, Muhamedi duke na treguar qëllimin e mesazhit të tij ka thënë: *“Në të vërtetë, jam dërguar që të plotësoj moralet e larta.”* Ndërsa bashkëshortja e të Dërguarit, Aishja (Allahu goftë i kënaqur me te), kur e pyeti dikush për moralin e Pejgamberit, ajo ishte përgjigjur: *“Moralin i Pejgamberit ishte Kurani”*. Pas këtyre fjalëve vjen argumenti i përgjigjes sime. Në atë vend ku mësohen moralet e larta jetësore, të vjela nga Kurani Famëlartë dhe merret shembulli i njeriut më të mirë nga sipërfaqja e tokës, Pejgamberi Muhamed, paqja dhe bekimet qofshin mbi të, pikërisht aty nuk ekziston fenomeni i vetëvrasjes. Për t'u bindur të gjithë mjafton që të bëhet një hulumtim i njerëzve që frekuentojnë xhamitë tona, këtu në Kosovë, atëherë do të bindemi se morali dhe mësimi që kanë marrë aty, pothuajse e ka çrrënjësuar plotësisht fenomenin e vetëvrasjes për frekuentuesit e vet. Në anën tjetër, ata që e kanë bërë një akt

të tillë (vetëvrasjen), vështirë se në mesin e tyre do të gjendet goftë edhe vetëm një, që ka qenë frekuentues i rregullt i xhamive.

Tek ne, si popull me shumicë muslimane ende mbetet i habitshëm fakti se përse duhet të hezitohet që Kurani Famëlartë të jetë ndikues në zemrat dhe sjelljet tona. Përse të mos e ftojme që të na ndryshojë gjendjen tonë. Përse përderisa është diagnostikim perfekt dhe zgjidhje që të çon menjëherë në shërim. E megjithatë refuzohet. Edhe pse jemi muslimanë, ende nuk i përdorim parimet e fesë sonë për t'i larguar të këqijat, që vijnë nga tundimet e ndryshme jetësore. Me një fjalë, për ta përsosur moralin e sjelljeve tona dhe për të ndihmuar të gjithë ata që e kërkojnë këtë.

Derisa fenomeni vetëvrasje po përhapet edhe nëpër shkolla, unë mendoj se është nevojë urgjente që më së pari të kemi kurajën t'i pranojmë rezultatet e fesë sonë në këtë aspekt. Në xhami shohim shumë nxënës, studentë, të diplomuar dhe qytetarë të ndryshëm, që kur diskutojnë për fenomenin e vetëvrasjes, ata shprehin vetëm keqardhje për viktimat dhe asnjëherë nuk e pranojnë këtë akt si pjesë të tyre. Kjo vjen thjesht, sepse ata marrin njohuri të tjera për moralin e sjelljes dhe respektit ndaj jetës. Marrin njohuri mbi sprovat dhe vështirësitë e ndryshme që paraqiten në jetën e një njeriu dhe po ashtu mësojnë edhe për mekanizmat e përballimit të tyre, duke e mohuar plotësisht ikjen nga sprova me anë të vetëvrasjes. Pejgamberi, *alejhi salatu ue selam*, ka thënë: *“E çuditshme është çështja e besimtarit. Çështja e tij është krejt mirë për të dhe nuk është e tillë për askënd tjetër. Nëse besimtarin e godet gëzimi, ai falënderon (Allahun), e kjo i sjell dobi, kurse nëse e godet e keqja, ai bën durim (sabër), por edhe kjo i sjell dobi (shpërblim)”*. Nga ky shembull, që na e ka dhënë njeriu më i mirë, marrim një model të mrekullueshëm jetese, se si duhet t'i

“...Aty ku është Feja Islame, aty është edhe modeli i mrekullueshëm që përsos sjelljen...”

kthejmë sprovat dhe fatkeqësitë në përfitime dhe privilegje. Duke u pajtuar me situatën momentale, që mund të jetë e pafavorshme dhe duke shpresuar me durim në mëshirën e Zotit, Mëshiruesit, besimtari i sinqertë thjesht e gjen paqen, edhe në varfëri, edhe në mungesën e perspektivës momentale, sepse ai e di që të gjitha mirësitë dhe fatkeqësitë e kësaj bote janë momentale dhe janë sprovë e vazhdueshme ndaj tij. Përpjekja për t'i zgjidhur problemet përmes vetëvrasjes, natyrisht është gjithmonë e dështuar. E, në këtë dështim, besimtari fetarisht e ka të ndaluar të ecë, sepse ai përveç të tjerash ndien frikërespekt ndaj Krijuesit të jetës.

Gjithashtu nxënësit që falin namazin, që edukohen me disiplinë fetare, u bëjnë ballë edhe sfidave të propaganduesve të prezervativëve, të cilët mjerisht e kanë gjetur terrenin edhe në shkolla. Këta nxënës e dinë që kjo propagandë, që bëhet në emër të shëndetit dhe shtatzënisë së padëshirueshme, hap varrin tjetër – atë të marrëdhënieve jolegjitime seksuale. Pra, të jetës së shfrenuar në liri të plotë me intimitete me këdo. Akoma injorohet fakti se seksi jomartesor është njëri nga burimet që shumë njerëz i ka çuar në vetëvrasje, alkoolizim dhe drogë (edhe këto dy të fundit, fenomene po ashtu të dëmshme për shëndetin). Këshilla për prezervativët, nëse do të ishte e nevojshme do të duhej të vllente vetëm për të martuarit dhe jo të përhapen informacione se kjo e mbron shëndetin. Në bazë të këtij konteksti, atëherë pyes: Çfarë shëndeti mund të ketë një nxënës, nëse ne e zhveshim nga shëndeti shpirtëror

dhe i mësojmë jetën e shfrenuar të marrëdhënieve jashtëmartesore me prezervativë?!... Ku është mbrojtja e nderit dhe e dinjitetit, që jo rrallë herë humbja e tyre të drejton në rrugën e vetëvrasjes.

Lënda fetare në shkolla domosdo jep dituri për ta ndërtuar jetën

Mësim-besimi fetar në shkolla, lëndë kjo që padrejtësisht pengohet të funksionalizohet nga politika, do të ishte një mundësi e mirë për nxënësit, që në të ardhmen do të jenë edukues të brezave të rinj, të merrnin disa nga njohuritë që sot për sot ata i marrin në rrugë të ndryshme, përmes literaturës, miqve, xhamive etj. Mungesa e kësaj lënde çdo ditë e më shumë po kthehet në një lloj dëmtimi kolektiv shoqëror. Kjo neglizhencë e bërë qëllimisht për ta zbehur mësimin dhe vlerën e madhe që bart Feja Islame, po na i dëmton vlerat themelore të së drejtës për t'i dhënë fëmijëve tanë dituritë bashkëkohore dhe njohuritë mbi religjionin. Sot, nuk mund të gjejmë shoqëri demokratike, që në shkollat e tyre nuk e kanë mësimin fetar. Feja është mjeti më i thjeshtë për ta ndaluar dukurinë e vetëvrasjes, pa mohuar këtu edhe shkencat e tjera psikologjike –shëndetësore. Kushdo që e ka të vështirë të bindet për suksesin e fesë në këtë drejtim mund t'i hulumtojë shumë lehtë dhe t'i pyesë besimtarët, të cilët kanë përvetësuar dije fetare, se përse ata nuk blejnë litar apo kimikate për ta vlarë veten!? Përgjigja do të jetë kjo: Aty ku është Feja Islame, aty është edhe modeli i mrekullueshëm që përsos sjelljen. Natyrshëm që në sjelljen e përsosur vetëvrasja del jashtë protokollit. Në të kundërtën, nëse e lëmë jashtë jetëve tona fenë, atëherë, debatet televizive, seminarët, konferencat shkencore do të prodhojnë vetëm fjalë mbi këtë temë. ■

(autori është mësimdhënës në shkollën e mesme “Fehmi Agani” në Klinë)



FITNEJA E BASHKIMIT TË KUFRIT ME FORCËN MATERIALE

Mosbesimtarët, si këta që përmendëm, këtë epërsi materiale mbi të tjerët nuk e konsiderojnë vlerë e tyre të vetme. Ata janë të mendimit, se kjo epërsi materiale është provë (argument) për epërsinë e tyre njerëzore. Sipas tyre forca materiale që ata zotërojnë është argument për saktësinë e besimeve të tyre

PROF. DR. XHAFER SHEJH IDRIS

Në këtë botë me begatitë e Allahut kënaqen të gjithë, besimtarët dhe mohuesit. Për besimtarët ky realitet në vetvete ngërthen argumente për urtësinë absolute të Krijuesit, qoftë i Lartësuar. I Lartësuari thotë: *“Thuaj: “Kush i ka penguar (ndaluar) stolitë dhe ushqimet e këndshme, të cilat Ai i ka*

krijuar për robërit e Vet?” Thuaj: “Ato janë për besimtarë (dhe të tjerët) në këtë botë, ndërsa në botën tjetër do të jenë vetëm për besimtarët. Kështu ua shpjegojmë shpalljet njerëzve që dinë.” (Araf, 32)

Nga pjesa e ajetit *“Ato janë për besimtarë (dhe të tjerët) në këtë botë, ndërsa në botën tjetër do të jenë vetëm për besimtarët”* kuptojmë se ato stoli dhe

ushqime të këndshme në këtë botë, nuk janë e drejtë ekskluzive për besimtarët.

Kur Ibrahim babai i të dërguarve, alejhi selam, u lut: *“Zoti Im, bëje këtë vend qytet të sigurt dhe furnizoji me prodhime banorët e tij, ata që besojnë në Allahun dhe në jetën tjetër!”* Allahu u përgjigj: *“Atë që nuk beson për pak kohë do ta bëj që të kënaqet e pastaj do ta hedh në dënimin e zjarrit.”* (Bekare, 216)

Në realitetin përreth e shohim vërtetësinë e fjalëve të Allahut. Mohuesit në çdo kohë dhe vend vazhdojnë të kënaqen me mirësitë e kësaj bote. Edhe në këtë kënaqje shfaqet lajthitja e mosbesimtarëve:

Ata nuk e falënderojnë Allahun dhe e mohojnë mirësinë e Tij.

Janë të bindur se këto të mira ata i kanë merituar me dijen, mençurinë dhe angazhimin e tyre.

Ka prej tyre që mendojnë se Allahu ua ka dhënë këto begati, sepse ata i meritojnë. Ja ku e kemi fjalën e Karunit¹ i cili tha: *“Kjo më është dhënë vetëm prej diturisë sime”. Vallë, a nuk e dinte ai, se Allahu kishte zhdukur para tij shumë brezni, që kishin qenë më të fuqishëm dhe që kishin grumbulluar më shumë pasuri se ai? Por keqbërësit nuk do të pyeten për gjynahet e tyre.”* (Kasas, 78)

Në komentin e këtij ajeti Ibën Kethiri thotë: Karuni tha: Kjo më është dhënë, sepse Allahu e di që unë e meritoj. Më do prandaj m'i dha këto gjëra, që unë i zotëroj.

“...Ata që nuk logjikojnë gjatë vlerësimit të gabimit mbështeten në gjendjen materiale të folësit...”

Pronari i dy kopshteve tha: *“Pastaj hyri në kopshtin e vet dhe, duke qenë i padrejtë me vetveten tha: “Unë nuk mendoj se kjo do të shkatërrohet ndonjëherë dhe nuk mendoj se do të arrijë ndonjëherë Ora (e Kiametit). Por edhe nëse do të më kthejnë te Zoti im, sigurisht që do të gjej një vend më të mirë se ky (kopsht)”!* (Kehf, 35-36)

Mosbesimtarët, si këta që përmendëm, këtë epërsi materiale mbi të tjerët nuk e konsiderojnë vlerë e tyre të vetme. Ata janë të mendimit, se kjo epërsi materiale është provë (argument) për epërsinë e tyre njerëzore. Sipas tyre forca materiale që ata zotërojnë është argument për saktësinë e besimeve të tyre dhe mënyrën e jetesës së tyre. Ata që zotërojnë më pak fuqi besojnë gabimisht dhe gabimisht jetojnë.

Kur u lexohen vargjet Tona të qarta, jobesimtarët u thonë atyre që kanë besuar: “Cili grup ka pozitë më të mirë dhe rreth më të mirë?” Por sa e sa brezni, që kanë qenë më të begatshëm dhe më të pashëm, Ne i kemi shkatërruar para tyre!” (Merjem, 73-74)

Ai që është i mençur saktësinë e asaj që i thuhet e vlerëson me prova. Nëse i gjen

¹ Karuni ka qenë anëtar i fisit të Musait alejhi selam (ashtu si ai, ishte prej fisit të Levit). Ishte një burrë me bukuri dhe forcë të madhe. Teuratin e njihte thellësisht dhe ishte shumë i pasur. Të gjitha këto cilësi e kishin bërë mendjemadh. Për ta ndëshkuar për mendjemadhësinë e tij, Allahu i Madhëruar e bëri që ta gllabëronte toka.

provat e saktësisë i pranon dhe nëse nuk i gjen ai i refuzon. Ata që nuk logjikojnë gjatë vlerësimit të gabimit mbështeten në gjendjen materiale të folësit, nëse ai është i pasur sa ata ose më i pasur, atëherë fjala e tij pranohet si e saktë. Nëse gjendja e tij është më e ulët se e tyre, atëherë fjala e tij has në refuzim. Me këtë logjikë, duke i krahasuar shtëpitë e tyre dhe vendet ku tuboheshin me shtëpitë dhe vendtakimet e besimtarëve, ata arritën në konkluzion të gabuar, shirku (politeizmi) është më i saktë se teuhidi (njësimi i Allahut) me të cilin erdhën të gjithë të Dërguarit e Allahut.

Allahu ua përkujtoi faktin se kënaqësitë materiale nuk mundën të jenë argument për saktësinë/vërtetësinë e ndonjë pohimi. Po të ishte ashtu Allahu nuk do t'i shkatërronte ata që kishin **më tepër pasuri, orendi, që ishin më të bukur dhe që kishin formë më të mirë.** (Ibën Kethir)

Në këtë lidhje shkakësore mes hakut dhe forcës materiale, e që në thelb është mohuese e besimit të pastër, hise kanë edhe disa muslimanë. Këtë në veçanti e gjejmë tek muslimanët bashkëkohorë, që përditë ballafaqohen me epërsinë materiale të mosbesimtarëve. Vendet e pazhvilluara (e shumë prej tyre janë vende me shumicë muslimane) sot etiketohen si të prapambetura, emërtim ky që nuk ka të bëjë vetëm me zhvillimin e tyre ekonomik, por është edhe një formë e përçmimit moral dhe njerëzor. Ata muslimanë që i quajnë vendet e tyre me këto emra harrojnë se romakët dhe persianët në kohën e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut

qofshin mbi të, kishin një infrastrukturë më të zhvilluar. Le të shikojmë për shembull xhaminë e të Dërguarit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, institucionin më të lartë asokohe, shtyllat e saj ishin trungjet e palmave, ndërsa çatinë e mbulonin gjethe të palmës. Nuk ishte e shtruar me qilima të shtrenjtë. Njerëzit më të dalluar të historisë faleshin në tokë. Kur binte shi vendi i faljes bëhej lloç. Bëj vetëm një krahasim mes xhamisë dhe gjendjes së kishave dhe manastireve në Evropë. Allahu që e dinte me hollësi këtë realitet atë xhami të thjeshtë e zgjodhi si vend, ku do të shpallej mesazhi i tij. **“Allahu e di më mirë se kujt ia jep mesazhin e Vet.”** (Enam, 124)

Kjo që u tha nuk do të thotë se forca materiale nuk është e rëndësishme, përkundrazi ajo është e rëndësishme, sepse mëkëmbja në tokë nuk realizohet pa forcë. Ajo është në vendin e dytë pas fesë së vërtetë. Besimtarët e kësaj feje Allahu i ndihmoi dhe u dha forcë me të cilën ngadhënjyen dhe i nënshtruan vendet që përmendëm. Nderimi i tyre erdhi pasi ata e vërtetuan besimin e tyre ndaj të vërtetës me të cilën erdhën të Dërguarit e Allahut. Epërsia e tyre mbi vendet që nënshtruan ishte epërsi e besimit, e vlerave dhe e sjelljes. Kështu do të përfundojë çdokush që ecën pas gjurmëve të tyre.

I Lartësuarit në shumë ajete të Librit të tij na alarmon për rrezikun e mashtrimit me të mirat që kemi, e në veçanti me të mirat materiale.

“Askush nuk i vë në dyshim shpalljet e Allahut, përveç atyre që nuk besojnë, prandaj mos të mashtroni ty bredhja e tyre nëpër botë.” (Gafir, 4) Taberiu duke

folur rreth këtij ajeti shkroi: Mos të mashtrujë ty, o Muhamed, sjellja e tyre në botë dhe mbetja e tyre në të, pasi ngelën mosbesimtarë. Atyre u është dhënë afat, prandaj me mosbesimin e tyre ata bredhin dhe sillen nëpër botë. Allahu nuk ua ka përshpejtuar belanë dhe dënimin, për shkak të asaj pjese të vërtetë në të cilën janë akoma. I Lartësuari thotë: *“Ti (o Muhamed) mos u mashtro nga bredhja e jobsimtarëve nëpër botë! Kjo mirëqenie është e shkurtër; pastaj, strehimi i tyre është Xhehenemi. Eh, sa shtrat i keq është ai vend! Ata që i frikësohen Zotit të tyre do të kenë kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përjetësisht, si dhuratë prej Allahut. Dhe ajo që është tek Allahu është dhurata më e mirë për besimtarët e vërtetë.”* (Ali Imran, 196-198)

Ata që përparimi material i mosbesimtarëve i bën të dyshojnë në fenë e tyre, dhe me këto fakte u dobësohet imani, krahas dobësisë materiale vuajnë edhe nga dobësia fetare. Para disa vitesh isha në një konferencë islame dhe u takova me një thirrës, i cili vinte nga një vend evropian. Më befasuan fjalët që tha ai: demokracia është sistemi më i mirë tek i cili arriti njerëzimi. Ajo që gjithashtu me befasoi ishte fakti, që këto fjalë, të cilat në thelb vijnë ndesh me besimin, i përsërisin më shumë besimtarë që falen. Nga kjo fjalë nënkuptojmë se demokracia është sistemi më i mirë se gjykimi me Librin e Allahut dhe Sunetin e të Dërguarit. Sipas shariatit ai që gjykon dhe cakton dispozitën është Allahu, ndërsa në demokraci kjo e drejtë u jepet njerëzve, me dallimet që kanë ndërmjet tyre. Prandaj ndodh që gjykimet e dy njerëzve

“...Ata që përparimi material i mosbesimtarëve i bën të dyshojnë në fenë e tyre, dhe me këto fakte u dobësohet imani, krahas dobësisë materiale vuajnë edhe nga dobësia fetare...”

për një çështje të kenë mospërputhje, të ndeshen dhe të mbesin demokratike. Me këtë janë sprovuar edhe shumë muslimanë që zgjedhjen e zezakut Obama për kryetar të SHBA-ve e konsideruan si provë për drejtësinë e demokracisë. Këta harruan se kjo demokraci nuk i ndaloi madje edhe i lejoi ekspeditat në Afrikë për gjuetinë e njerëzve dhe robërimin e tyre. Këta njerëz pastaj me anije transferoheshin në Amerikë, ku shiteshin në ankande publike, ashtu si shiten kafshët. Demokracia nuk i detyroi njerëzit që ta zgjedhin Obamën, e as që ua ndaloi zgjedhjen e tij. Çfarë pra është e mrekullueshmja në këtë gjë?! E mrekullueshme është të gjykosësh si gjykon Islami, i cili nuk i vlerëson njerëzit sipas ngjyrës, por sipas devotshmërisë. Arabi nuk është më i vlefshëm se sa jo arabi përpos me devotshmëri. ■

Nga arabishtja: Talha KURTISHI



ZOTI, I MADHËRISHMI

Zoti i Madhërishëm, kur e di se cili prej krijesave e meriton mirësinë, dashurinë, njohjen dhe njësimin e Tij, ia bën këto gjëra atij të dashura dhe e vendos në udhën e tyre, ia skalit ato në zemër, i jep sukses, i vjen në ndihmë dhe ia lehtëson rrugët

HALID IBËN MUHAMED SELIM

Lavdet i përkasin Allahut, Zotit të botëve. Bekimet dhe uratat më të mira qofshin për më të mirin e Profetëve dhe të të Dërguarve, Profetin tonë Muhamed, për familjen dhe shokët e tij.

Zoti (arabisht: Rrab). Një nga emrat më të mëdhenj të Allahut dhe me shumë kuptime përfshirëse. *Rrab*, është ai që rrit dikë tjetër dhe kujdeset për të hap pas hapi. Kjo fjalë përdoret për pronarin, zotërinë, rregulluesin e punëve,

edukatorin, kujdestarin, bamirësin.¹

Zoti ynë është Ai që krijon, furnizon, i rregullon çështjet, jep dhe privon, udhëzon dhe lë në humbje, çdo gjë që ka në univers është i nënshtuar dhe i përlurur i Tij, askush nuk del jashtë pushtetit të Tij. Emri *Rrab* bashkë me emrin “Allah” dhe emrin “Rrahman”, janë emrat ku kthehen të gjithë emrat e bukur të Zotit. Dhe pikërisht Allahu me këta emra e nis fjalën e Tij, në suren më madhështore në Kuran, suren *Fatiha*.

İbën Kajimi thotë: “Shiko me kujdes

¹ Tefsir Tabari 1/47, Nihajetu fi garbi el-hadith 1/179.

lidhjen që ka në mes krijimit dhe urdhrit, me këta tre emra: *Allah, Rrab* dhe *Rrahman*, sesi prej tyre vjen krijimi, urdhri, shpërblimi dhe ndëshkimi, sesi e grumbullojnë krijesën dhe e ndajnë atë. Këtyre emrave u përket bashkimi dhe ndarja. Emrit *Rrab*, i takon bashkimi i të gjitha krijesave, Ai është zoti i çdo gjëje, krijuesi i tyre dhe i plotfuqishmi mbi to. Asgjë nuk del jashtë zotërimit të Tij, çdo gjë që ka në qiej dhe në tokë është skllav i Tij, në grushtin e Tij dhe nën pushtetin e Tij. Të gjitha krijesat i bashkon atributi i zotërimit, që ka Allahu dhe i ndan atributi i hyjnisë së Tij; e kanë hyjnizuar Atë të vetëm, të lumturit dhe e kanë pranuar me bindje se Ai është Allahu, veç të Cilit nuk ka hyj tjetër veç Tij.”²

Zoti, i Madhërishmi, është Ai që solli në ekzistencë krijesat dhe i zhvilloi ato; Ai është që i udhëheq ato dhe i ndreq; Ai është që u sistemoi jetën dhe rregulloi çështjet e tyre: **“Në të vërtetë, Zoti juaj është Allahu, që i krijoi qiejt dhe tokën për gjashtë ditë e pastaj u ngrit mbi Fronin hyjnor (që mbisundon gjithësinë). Ai me errësirën e natës e mbulon ditën, e cila e ndjek atë; Dielli, Hëna dhe yjet i përulen urdhrit të Tij. Vetëm Atij i përket Krijimi dhe Urdhërimi. Qoftë bekuar Allahu, Zoti i botëve!”** (Araf: 54).

Ky zotërim i Allahut është i përgjithshëm, ndaj çdo krijese, dhe askush në këtë drejtim nuk bën përjashtim, dhe nuk ka vlerë më tepër se dikush tjetër. Zotërimi më i rëndësishëm dhe më me vlerë është zotërimi i veçantë, ai ku Allahu u vjen në ndihmë miqve të Tij dhe i edukon ata nën mbikëqyrjen e Tij të veçantë.

Ibën Sadi thotë: *“Rrab* është rritësi i të gjithë krijesave të Tij, me përkujdesje dhe

“...Si mundet që ky njeri të adhurojë dikë që është nën zotërimin e Allahut?! Si mundet t'i drejtohesh me lutje dikujt që nuk i bën dobi vetes?!...”

mirësi. Më e veçanta e këtij emri është kujdesi që Ai tregon ndaj të zgjedhurve të Tij, duke ndrequr zemrat, shpirtrat dhe moralin e tyre. Për këtë edhe lutjet e tyre me këtë emër madhështor janë të shumta, sepse ata kërkojnë prej Tij pikërisht këtë përkujdesje të veçantë.”³

“Zoti i Madhërishëm, kur e di se cili prej krijesave e meriton mirësinë, dashurinë, njohjen dhe njësimin e Tij, ia bën këto gjëra atij të dashura dhe e vendos në udhën e tyre, ia skalit ato në zemër, i jep sukses, i vjen në ndihmë dhe ia lehtëson rrugët. Veç kësaj Allahu ia mbyll atij portat që e largojnë prej Tij dhe më pas e mbikëqyr me butësinë, lehtësinë, rregullin dhe edukimin e Tij, shumë më mirë sesa përkujdesja e prindit të mëshirshëm e të dhembshur me fëmijën e tij, që është gjëja më e dashur për të. Zoti sillet gjatë gjithë kohës me robin e Tij me butësi, e veçon atë me mirësinë dhe mëshirën e Tij, i vjen në krah me ndihmën dhe suksesin e Tij, i tregon pozitën e bamirësisë e dashamirësisë së Tij, e kështu robi i Tij shton njohjen për Zotin e tij, dashurinë, pendesën, mbështetjen dhe nuk do tjetër veç Tij askënd, nuk adhuron bashkë me Të asnjë. Ky është ai që njeh vlerën e së mirës, njeh Bamirësin, pranon

² Medarixhu es-Salikin 1/34.

³ Tefsir es-sadi 16.

mirësinë e Tij dhe e shpenzon atë në kënaqësinë e Tij.”⁴

Kur kjo njohje arrihet me zemër nga njeriu, ajo shndërrohet në udhën e jetës dhe jep fryte të bekuara. Prej këtyre fryteve vjen mbushja e zemrës me dashurinë për këtë Zot të Madhërishëm. Dashuria lind prej një nga këto dy gjëra:

E para, nga qenia dhe atributet e Tij të larta, që Ai i meriton ato.

E dyta, nga mirësia dhe bamirësia e Tij, e aq më tepër që Zoti nuk ka nevojë për krijesat e Tij. Zoti sillet me mirësi me krijesat e Tij, për shkak të mëshirës, bujarisë dhe dashamirësisë së Tij, jo për shkak të kompensimit, as për të përfituar diçka apo për të larguar ndonjë dëm të caktuar.⁵ Prej këtyre fryteve është edhe hareja dhe kënaqësia me Allahun. Nuk ka në këtë botë asnjë që të bëjë atë që bën Zoti ynë i Madhërishëm, Allahu i Lartësuar thotë: **“Thuaj: “A mos vallë do të kërkoj unë tjetër zot, përveç Allahut, kur Ai është Zoti i gjithçkaje?”** (Enam: 164).

Një njeri i tillë krenohet me fenë e tij dhe urren të bëhet mohues, ashtu siç urren të digjet nga zjarri. Ky fryt madhështor prodhon ëmbëlsinë e besimit dhe e gjithë jeta e tij është lumturi, ai përkundet në këtë mirësi ndonëse gjendet akoma në botën e punës e të sprovës. Abas ibën Abdulmutalibi tregon se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut, *alejhi salatu ue selam*, të thotë: **“Ai që është i kënaqur me Allahun si zot, Islamin si fe dhe Muhamedin si të Dërguar, ka shijuar ëmbëlsinë e besimit.”** (Muslimi).

Enesi përcjell nga Profeti, *alejhi salatu ue selam*, se ai ka thënë: **“Nëse njeriu arrin tri gjëra, gjen ëmbëlsinë e besimit: nëse Allahu dhe i Dërguari i Tij janë për të më të**

dashur se gjithçka, nëse dashurinë që njeriu ka, e ka vetëm për hir të Allahut dhe nëse urren të kthehet në mohim, pasi Allahu e shpëtoi prej tij, ashtu siç urren të hidhet në zjarr.” (Buhariu).

Prej fryteve madhështore është edhe t'i drejtohesh Zotit për ta adhuruar Atë të vetëm; nënshtrimi para Tij dhe para askujt tjetër. Si mundet që ky njeri të adhurojë dikë që është nën zotërimin e Allahut?! Si mundet t'i drejtohesh me lutje dikujt që nuk i bën dobi vetes?! Allahu i ka qortuar shumë në Kuran mohuesit, për shkak të mohimit të tyre, ndonëse ata e pranonin se Allahu ishte Krijuesi, dhe Furnizuesi i vetëm, ashtu siç e pranonin se perënditë e tyre nuk kishin asgjë në dorë **“Thuaj: “Kush ju ushqen nga qielli dhe Toka? Kush mundëson të dëgjuarit dhe të parit? Kush mund të nxjerrë të gjallën nga e vdekura dhe të vdekurën nga e gjalla? Kush i drejton gjërat?”** Ata do të thonë **“Allahu”**. E ti (o Muhamed) thuaj: **“Atëherë, përse nuk e keni frikë Atë?”** Ky është Allahu, Zoti juaj i vërtetë. E çfarë ka pas së vërtetës, përveç humbjes? Atëherë, përse largoheni?” (Junus: 31-32)

Fakti që Ai është Krijuesi, Furnizuesi, Pronari i kësaj bote dhe i banorëve të saj, që Ai i mban në jetë ata, kjo do të thotë se Ai e meriton të adhurohet i vetëm dhe të mos i sajohet Atij ortak: **“Ai që e ka bërë për ju tokën shtresë dhe qiellin ndërtesë; që prej së larti zbret ujë dhe nëpërmjet tij bën që të rriten fruta si ushqim për ju. Prandaj mos sajoni me vetëdije zota të barabartë me Allahun.”** (Bekare: 22).

Pra, mos i sajoni ortak Allahut, perëndi që as sjellin dëm e as dobi dhe ju e dini se nuk ka ndonjë zot që ju furnizon juve veç Tij, ashtu siç e dini se i Dërguari që u

⁴ Tarik el-hixhretejn 1/172.

⁵ Miftah daru es-seade 2/91.

thërret për në njësimin e Zotit, është në të drejtë dhe thotë të vërtetën, për të cilën nuk ka dyshim. Shirku padyshim që është gjynahu më i madh, siç tregohet kjo nga Ibën Mesudi, që thotë: i thashë: “O i Dërguari i Allahut, cili është gjynahu më i madh tek Allahu? Ai tha: *“T’i sajosh Allahut ortak, kur është Ai që të ka krijuar ty.”*⁶ Prej fryteve të njohjes së Zotit, është edhe largimi nga çdo idhull që adhurohet në vend të Tij. Është sakrifica për të luftuar shirkun, për ta zhdukur atë nga faqja e dheut dhe për të lartësuar fenë i këtij Zoti Madhështor dhe të vetëm. Allahu i Lartësuar thotë për Ibrahimin, *alejhi selam*: *“Ai tha: “A keni menduar mirë mbi çfarë keni adhuruar, si ju, ashtu edhe të parët tuaj të lashtë? Në të vërtetë, ata janë armiq të mi, përveç Zotit të botëve, që më ka krijuar dhe më udhëzon (në rrugë të drejtë); që më ushqen dhe më jep të pi; që kur sëmurem, më shëron; që do të më bëjë të vdes e pastaj do të më ringjallë; dhe që shpresoj se do të m’i falë gabimet e mia në Ditën e Gjykimit! O Zoti im, më dhuro dituri dhe më radhit me të mirë! Bëj që të përmendem për të mirë te breznitë e ardhshme dhe më bëj një nga trashëgimtarët e Xhenetit të begatë!”* (Shuara: 75-85).

Dhe kështu Ibrahim, *alejhi selam*, njësimin e Zotit, në zotërimin, plotfuqishmërinë dhe adhurimin e Tij e bëri rrugën e jetës së tij. Kjo rrugë ia shtoi atij sprovat, por e ruajti atë gjatë vdekjes; ky është robi i Zotit, të cilin Allahu urdhëroi robërit e Tij ta merrnin si shembull, në besim, në fjalë dhe në vepra. Allahu i Lartësuar thotë: *“Bëhuni robër të ditur të Zotit* (që i zbatojnë porositë e Tij), *sepse ua keni mësuar Librin të tjerëve dhe*

“Të ndjesh zotërimin dhe përkujdesjen e veçantë të Zotit është ndoshta e fshehta, pse Profetët dhe njerëzit e afërt tek Allahu e lusnin Zotin kaq shumë me këtë emër, Rrab, në dallim me emrat e tjerë. Të ndjesh këtë gjë gjatë lutjes është shumë e dobishme...”

e mësoni edhe vetë!” (Ali Imran: 79).

Buhariu në komentën e këtij ajeti na përcjell një koment të Ibën Abasit që thotë: “Bëhuni robër të ditur të Zotit, njerëz të urtë dhe të mençur.”

Prej fryteve të njohjes është edhe fakti, se kur robi e di mirë se vetëm Zoti është Ai që sjell dëm edhe dobi, që jep dhe privon, që krijon dhe furnizon, që jep jetë dhe vdeke, kjo gjë zhvillon në brendësi të tij adhurimin e mbështetjes te Zoti, e po kështu edhe në veprimet e tij të jashtme ndjehet dhe shihet kjo gjë. Ky njeri hallin e tij ia qan vetëm Zotit të tij, sepse ai kurrë nuk mendon keq për Të. Prej fryteve është edhe veshja e njeriut me rrobën e skllavit dhe të nënshtrimit, duke larguar prej tij rrobën e të qenit zot, gjë që nuk i takon, sepse ky njeri e di mirë se kjo veshje i takon Atij që është më i lartë se çdo gjë, Atij që ka në dorë pushtetin. Një njeri i tillë pranon atributet e madhështisë së

⁶ Buhariu 447, Muslimi 86, Tefsir Ibën Kethir 1/58.

Zotit, dhe nuk përpiqet të rivalizojë me Zotin e botëve në ligjet e Tij të përsosura, apo t'i largohet rrugës së Profetit dhe Sunetit të tij.⁷ Prej këtyre fryteve të njohjes së Zotit, është edhe kontakti me përkujdesjen e veçantë të Allahut, aq sa robi mundet të marrë prej kësaj përkujdesje. Njeriu i lutet dhe i përgjërohet Zotit të tij me këtë emër të madh, *Rrab*, i thërret Atij në çdo kohë dhe vend, që të bëhet prej miqve të Tij, në shpirtrat e të cilëve vetë Zoti ka mbjellë fisnikëri, të cilëve që më parë Zoti i tyre u pat dhuruar mirësi dhe diçka plus. Ky njeri këmbëngul në këtë rrugë, ashtu siç bëjnë të zgjedhurit e Zotit, për të cilët Ai thotë: ***“Për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës*** (duke thënë): ***“O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh*** (nga çdo e metë)! ***Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.***” (Ali-Imran: 191).

Të ndjesh zotërimin dhe përkujdesjen e veçantë të Zotit është ndoshta e fshehta, pse Profetët dhe njerëzit e afërt tek Allahu e lusnin Zotin kaq shumë me këtë emër, *Rrab*, në dallim me emrat e tjerë. Të ndjesh këtë gjë gjatë lutjes është shumë e dobishme.⁸

Prej këtyre fryteve është edhe përkujdesja, që robi i Zotit duhet të tregojë ndaj krijesave që Allahu ia ka vënë nën vete, si frikë dhe përkushtim ndaj vetë Zotit. Por ai kurrë nuk duhet ta ndjejë dhe ta etiketojë veten e tij si zot, si shenjë modestie ndaj Zotit të tij, si shenjë njësimi ndaj Emrit dhe atributit të Allahut, edhe pse lejohet që dikush tjetër mund ta

etiketojë atë kështu. Ebu Daudi na përcjell një hadith autentik në librin e tij, se Abdullah ibën Xhaferi thotë: “I Dërguari i Allahut hyri brenda një kopshti të një prej banorëve të Medinës dhe pa një deve. Kur deveja pa Profetin filloi të ankohej dhe i rrodhën nga sytë lot. Profeti i shkoi pranë e fërkoj pas veshit dhe ajo pushoi. Ai tha: *“Kush është i zoti i kësaj deveje? Kujt i përket kjo deve?”* Një djalosh prej medinasve erdhi dhe i tha: “Më përket mua, o i Dërguari i Allahut.” Profeti i tha: *“A nuk e ke frikë Allahun për këtë kafshë, të cilën Ai ta ka vënë nën pronësi? Ajo u ankua tek unë se ti e lë atë të uritur dhe e mundon.”*⁹

Ndërsa ndalimi i përdorimit të kësaj fjale për njerëzit, si shenjë modestie ndaj Allahut është përmendur në librin e Buhariut, në një hadith që e përcjell Ebu Hurejra se Profeti, *alejhi salatu ue selam*, ka thënë: *“Askush prej jush të mos i thotë (një skllavi): ushqeje zotin tënd, ndriçoje zotin tënd, jepi të pijë zotit tënd. Ai (skllavi) le të thotë: zotëria im, zotëria im. Askush prej jush të mos thotë: skllavi im, skllavja ime, por le të thotë: djaloshi im, vasha ime, shërbyesi im.”*¹⁰ ■

Nga arabishtja: Justinian TOPULLI


⁷ Esmaul Husna, dr. Mahmud Riduani 5/168.

⁸ Fethu rrahim el-melik el-alam. Ibën Sadi 48.

⁹ Sahih et-tergib 2269.

¹⁰ Buhariu 2/901 nr. 2414.

SI TA KËRKOSH DIJEN PERLA DHE MARGARITARË PËR NXËNËSIN E DIJES



1 SHTATOR 2009 11 Ramazon 1430 Viti XI nr. 74

HK 50 DEN KV 0.80 €
AL 100 LEK
ISSN 1409-6250
9 771409 625002

Ashtu si arma nuk mund të ketë efekt pa e përdorur ushtari, ashtu edhe libri nuk ka efekt pa nxënësin e tij. Prandaj myslimanët janë të nevojshëm më shumë se kurrë për njerëz të cilët e mësojnë fenë nga burimi dhe u dalin në mbrojtje atyre kur sulmohen nga armiqtë e pamëshirshëm.

SHKRUAN: ALAUDIN ABAZI

Nuk ka dyshim se dituria islame është njëra nga nevojat më të domosdoshme për tu drejtuar e përparuar umeti ynë. Kështu që nëse në këtë drejtim ka ngecje e shpërfillje, atëherë gjendja e umetit kthehet në zmbropsje e në rënie. Ndoshta në sqarimin e kësaj çështjeje, nuk kërkohet të ndalemi

shumë, meqë po t'i hedhim një vështrim realitetit dhe gjendjes së muslimanëve në kohën tonë, do të kuptojmë menjëherë se sa e drejtë dhe e saktë është kjo që u tha.

Gjithsesi viteve të fundit vërehet një ngjallje e interesimit rreth diturisë të muslimanët, gjë të cilën e kishin të humbur për shumë dekada. Falë Allahut ende është duke përparuar e duke u zhvilluar ky rizgjim i muslimanëve në raport me dijen dhe nxënien e saj.

Fatmirësisht frytet e këtij hovi vërehen edhe në zemrat e rinisë islame në vendin tonë. Sidoqoftë është e rëndësishme që në këtë kohë të drejtohet e mbikëqyret ky gjallërim, në mënyrë që ta bëjmë sa më imun përballë turbullirave ideologjike, intelektuale, morale, përçarëse etj., me të cilat ballafaqohet kjo sfidë. Në vazhdim të këtij shkrimi lexuesi do të ketë mundësinë të njoftohet me disa gjëra shumë të rëndësishme, që kanë të bëjnë me diturinë dhe nxënien e saj.

Vlera e diturisë

Nuk është objektivi i këtij shkrimi vënia në pah, se sa e rëndësishme dhe e vlefshme është dituria, por do ta përmendim vetëm një problem real, i cili duhet të kihet parasysh nga çdo njeri, i cili lexon rreth kësaj problematike. Fjala është për atë se në Islam kërkimi i diturisë është adhurim – ibadet. Përcillet nga disa dijetarë të kenë thënë: **“Dituria është lutje e fshehtë dhe adhurim i zemrës”**. Madje dituria është njëri nga adhurimet më të vlefshëm, që kryen njeriu, pasi është një domosdoshmëri që barazohet me domosdoshmëritë e tjera esenciale, pa të cilat nuk mund të jetojë njeriu. Ibën Kajimi në një rast thotë: **“Nevoja e zemrës për dituri nuk është sikurse nevoja e frymëmarrjes, por është edhe më e madhe se kjo... Vlera e diturisë në zemër është sikurse vlera e dritës në sy, ose vlera e të dëgjuarit për veshin, ose vlera e të folurit për gjuhën. Pra, nëse i mungon zemrës dituria, atëherë ajo është njësoj si syri i verbër, veshi i shurdhër dhe gjuha e**

memecit. Prandaj edhe Allahu i Lartësuar i quan të paditurit (inorantët), se janë të verbër, të shurdhër dhe memecë. Për shkak se kjo është veti e zemrave të tyre, që e kanë humbur diturinë e dobishme dhe për këtë mbeten të verbër, të shurdhër dhe memecë”¹.

Ibën Kajimi, Allahu e mëshiroftë, aludon në ajetet në të cilat Allahu i Lartësuar i krahason jobesimtarët, të cilët nuk logjikojnë dhe janë të padijshëm me të shurdhrit, memecët dhe të verbërit, Allahu i Madhëruar thotë: **“Ata janë të shurdhër, memecë e të verbër, ata nuk kuptojnë”².**

Llojet e diturisë Islame

Dituria Islame ndahet në tre lloje:

Dituri farz (e domosdoshme): Kemi si qëllim atë dituri me të cilën besimtari mëson gjërat esenciale të fesë së tij, pa të cilat nuk bëhet, si mësimi i bazave të Imanit, Islamit etj., ku me këtë lloj diturie detyrohet ta mësojë çdo musliman i moshës madhore.

Dituri farz kifaje: Dituri e patjetërsueshme për muslimanët që ta mësojnë, nëpërmjet së cilës ata zbatojnë e jetësojnë fenë e tyre në jetën e përditshme, por kjo dituri nuk është e detyrueshme ta mësojnë të gjithë muslimanët. Kështu, nëse një grup prej tyre e marrin përsipër dhe e mësojnë, atëherë detyrimi bie nga të tjerët.

Dituri mustehab (e preferuar): Çdo dituri islame që është më pak e rëndësishme se dy llojet e para, konsiderohet dituri e preferuar që ta

¹ “Miftah Dari Seade”, vëll. I, fq. 111.

² Bekare, 171.

³ “El Ilmu”, Nasir El Umer, fq. 8.

mësojmë dhe ta njohim³.

Ndarja dhe klasifikimi i njohurive në lloje na jep të kuptojmë se jo të gjitha dituritë janë të një rëndësie që të mësohen dhe të kërkohen. Pastaj, gjithashtu dihet se dituritë e njohuritë janë të shumta dhe të gjitha ato, nuk mund t'i përvetësojë një njeri i vetëm. Për këtë kanë thënë në të kaluarën, se **njeriu sa më shumë që kërkon dituri, aq më shumë kupton se sa pak di**. Përderisa dituria është shumë e madhe, ndërsa jeta e njeriut shumë e shkurtër, atëherë mos e angazho veten me atë dituri, që është më pak e rëndësishme, ose aspak e rëndësishme, duke e neglizhuar të rëndësishmen. Kështu t'i e fut jetën në diçka që nuk është e nevojshme ta dish dhe humb mundësinë të fitosh atë dituri për të cilën do të kesh nevojë.

Etika e kërkuesit të diturisë

Nxënësi i dijes ndërmerr një rrugë mjaft të gjatë dhe atij gjatë këtij udhëtimi i kërkohet që të pajiset me nozullime dhe zahire për të cilat ai do të ketë nevojë, prandaj nga gjërat më të rëndësishme që ai duhet të ketë parasysh janë:

Sinqeriteti dhe pastrimi i qëllimit:

Më lart kemi sqaruar se kërkimi i diturisë është ibadet (adhurim) dhe për të qenë adhurimi i pranuar tek Allahu i Lartësuar, duhet që të bëhet vetëm për hir të Tij dhe të mos shoqërohet me ndonjë interes tjetër në këtë drejtim. Allahu i

Lartësuar thotë: **“E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë.”**⁴

Në një hadith shumë të njohur na përcillet, se Pejgamberi, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, ka thënë: **“Veprat vlerësohen sipas qëllimit....”**.

Kurse rreth atij që kërkon dituri islame për ndonjë qëllim tjetër i Dërguari, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, thotë: **“Kush mëson ndonjë dituri nga dituritë që me të realizohet afrimi tek Allahut (dituritë islame), kurse ai e mëson vetëm për të arritur me atë dituri ndonjë qëllim të kësaj bote, ai Ditën e Gjykimit, nuk do ta gjejë as erën e Xhenetit**⁵”. Mjafton vetëm ky hadith për të kuptuar se sa qenësore është pastrimi i nijetit për nxënësin e dijeve islame.

Largimi i paditurisë nga vetja dhe nga të tjerët:

Nxënësi i dijes duhet të ketë si qëllim me mësimin e tij largimin e injorancës nga vetja dhe nga të tjerët, meqë njeriu në esencë është i padijshëm dhe nxënësi i dijes mëson për ta larguar paditurinë dhe për t'u ngritur, Allahu i Lartësuar thotë: **“Allahu ju ka nxjerrë nga barku i nënave tuaja e ju nuk dinit asgjë dhe ju dha të dëgjuarit, të parët dhe zemrat, që të jeni falënderues.”**⁶.

Pastaj me ngritjen e paditurisë njeriu arrin ta njohë drejt madhërinë e Krijuesit të tij, Allahu i Madhëruar thotë: **“Me të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm të dijshtmit, Allahu është vërtet i Plotfuqishëm dhe Falës.”**⁷

⁴ Bejineh, 5.

⁵ Shënon Ahmedi, Ebu Davudi dhe Ibën Maxheh, ndërsa Hakimi i vlerëson të saktë.

⁶ Nahl, 78.

⁷ Fatir, 28.

“...pjesëmarrja në fitne, mos-marrëveshje dhe situata të tensionuara ku ngrihen zërat, ndodhin përbuzje, madje edhe ofendime e sharje e bëjnë kërkuesin e dijes ta përuli veten dhe rrugën të cilën ai ka marrë...”

Mbrojtja e fesë:

Kërkuesi i dijes duhet ta ketë parasysh rolin e mbrojtjes dhe ruajtjes së fesë, pasi librat në vetvete pa u mësuar e pa u studiuar nuk mund ta mbrojnë fenë dhe fenë e ruan dhe mbron vetëm bartësi i saj. Krahasimi më i mirë në mes librit dhe kërkuesit të dijes do të ishte si arma me ushtarin. Ashtu si arma nuk mund të ketë efekt pa e përdorur ushtari, ashtu edhe libri nuk ka efekt pa nxënësin e tij. Prandaj myslimanët janë të nevojshëm më shumë se kurrë për njerëz të cilët e mësojnë fenë nga burimi dhe u dalin në mbrojtje atyre kur sulmohen nga armiqtë e pamëshirshëm.

4) Frika ndaj Allahut, më të Lartit

Nxënësi i dijes zbukurohet duke e plotësuar veten me frikë ndaj Allahut, më të Lartit, meqë kjo është baza kryesore e fesë, ashtu si thotë Imam Ahmedi: “Baza e fesë është frika ndaj Allahut, më të Lartit”. Angazhimi me frikë ndaj Allahut duhet të jetë në të gjitha aspektet, si ato të jashtmet dhe të brendshmet. Dijetari nuk

mund të konsiderohet dijetar i mirëfilltë, përderisa nuk vepron me dijen e tij dhe asnjë dijetar nuk e zbaton diturinë e tij përderisa të mos e ketë parasysh frikën ndaj Allahut të Lartësuar.

Pasimi i rrugës së të parëve

Kërkuesi i diturisë duhet ta pasojë rrugën e Pejgamberit, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, duke praktikuar sunetin e tij gjatë marrjes së dijes. Pastaj nga ai kërkohet që ta kuptojë se gjenerata më e denjë për t’u pasuar pas Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, janë shokët e tij. Kështu që nxënësi i dijes nuk mund të futet në dituritë e shpikura, të cilat fatkeqësisht i atribuohen Islamit, por në fakt janë dituri që e devijojnë atë që është përcjellë nga Pejgamberi ynë, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të dhe sahabët e tij, Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë.

Pra, marrësi i dijes duhet të jetë pasues i Ehli Sunetit dhe Xhematit dhe u largohet diturive të devijuara, që janë shpikur më vonë nga grupacionet, të cilat u larguan nga rruga e saktë. Allahu i Lartësuar thotë: **“Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera, që t’ju shmangin nga rruga e Tij. Kjo është ajo që ju porosin Ai për t’u ruajtur nga të këqijat”**.

Mbikëqyrja e Allahut të Gjithëdijshëm

Kërkuesi i dijes e pajis veten me përkujtimin, se Allahu është në mbikëqyrje të tij gjithmonë dhe kudo që të jetë, haptas dhe në fshehtësi. Ai vazhdon rrugëtimin e dijes në mes të frikës dhe shpresës, sepse këto për muslimanin janë njësoj si krahët për zogun.

Zemërgjerësia në çështjet e diskutueshme.

Në gjërat për të cilat ka mendime të ndryshme dhe lejohet mospajtimi, ai duhet të jetë zemërgjerë dhe të ketë mirëkuptim. Ndërsa në meseletë në të cilat nuk lejohet mospajtimi e ixhtihadi, ai duhet të jetë i prerë, por gjithmonë duke pasur parasysh arsyetimin e dijetarëve, të cilët kanë rënë në mospajtime të tilla.

Stolisja e nxënësit të dijes me ndershmëri dhe moral

Morali dhe ndershmëria duhet të jenë shenjat dalluese me të cilat njihet nxënësi i dijes. Sjelljet e mira, fytyra e gëzuar, dhënia e selamit, vetëpërmbytja, urrejtja e mendjemadhësisë dhe e arrogancës, respektimi i të tjerëve, largimi nga tirania e përbuzja e të tjerëve, fisnikëria etj., duhet të jenë elementet kryesore të moralit të kërkuesit të dijes.

Largimi i tubimeve dhe bisedave të kota.

Marrësi i dijes nuk qëndron nëpër tubime dhe ndeja të cilat janë të padobishme e për më tepër nëpër ato vende ku njerëzit bëjnë gibet (përgojnë), përqeshin të tjerët dhe i tejkalojnë kufijtë e Allahut.

Largimi i trazirave:

Kërkuesi i dijes e mbron veten nga përfshirja nëpër trazira të panevojshme dhe të zhurmshme. Me të vërtetë gabimi qëndron pas tërbimit dhe kjo e kundërshton etikën e kërkimit të diturisë. Me fjalë të tjera, pjesëmarrja në fitne, mosmarrëveshje dhe situata të tensionuara ku ngrihen zërat, ndodhin

përbuzje, madje edhe ofendime e sharje e bëjnë kërkuesin e dijes ta përulë veten dhe rrugën të cilën ai ka marrë.

Të pajsurit me urtësi dhe mendjemprehtësi:

Me urti ose urtësi kemi si qëllim që nxënësi i dijes të jetë edukator i të tjerëve, kështu që ai t'i flasë çdo njeriu varësisht sipas rrethanave të tij dhe me atë që ai e pranon dhe pajtohet. Njeri i urtë është ai person që di t'ia gjejë vendin e duhur çdo gjëje. Urtësia është një veçori, e cila mund të përfitohet dhe të përsoset vazhdimisht te njeriu. Nëse çdonjëri ka nevojë për urtësi dhe mendjemprehtësi, atëherë nevoja për nxënësin e dijes është më e madhe. Prandaj ai duhet t'i lutet vazhdimisht Allahut të Madhëruar, që ta furnizojë me urtësi në çdo punë dhe vepër. Allahu i Lartësuar thotë:

“Ai ia jep urtësinë kujt të dojë. Kujtdo që i është dhënë urtësia, vërtet që i është dhënë një mirësi e madhe. Por këtë nuk e kupton tjetërkush, përveç njerëzve të mençur.”⁸ ■

(Vazhdon)

■
⁸ Bekare, 269.

THELBI I VLERËS PERSONALE


PËRGATITI AGRON TERZIQI

Në botë ekziston vetëm një gjë që ti me lejen e Zotit mund ta përmirësosh: vetveten. Ndryshimin e vetes bëje vetë dhe ajo mund të bëhet vetëm nga brenda,

e mos u përpiq ta bësh nga jashtë. Vlera personale përfshin përparimin e vetes. Kjo konsiderohet forca më e madhe inkurajuese, ndikuese dhe efektive për të nxitur njeriun në arritjen e një cilësie më të lartë gjatë përbushjes së detyrimeve.

1- Njihe realisht veten tënde. Përfito

Që në fillim le përshtypje të mirë. Vish rroba të mira dhe ke pamje elegante. Rrobat veshi të atilla që të përshtaten me ambientin e punës, pozitën dhe lëmin ku punon. Ji i përpiktë në takime. Fjalët tua hyrëse le të jenë me ndikim, fol me zë që dëgjohet, fol gjuhë të pastër, duke përdorur shprehje të bukura.



prej vetive të tua dalluese dhe tejkaloi pikat e tua të dobëta që të pengojnë në realizimin e arritjeve personale. Përcakto botëkuptimet dhe idetë e gabuara për veten dhe flaki menjëherë ato.

2- Mëso si ta duash veten, sepse ti je unik në llojin tënd. Mos bëj krahasime negative ndërmjet vetes dhe të tjerëve. Atë që nuk mund ta ndryshosh në veten tënde, pranoje. Ji në paqe me vetveten, ndalo së qeni armiku më i përbetuar i vetes.

3- Kur dëshiron të ndërmarrësh diçka dhe kur dëshiron të bashkëveprosh me sfidat e jetës, ki besim në potencialet e tua. Mësohu t'i flasësh vetes pozitivisht. Imagjinoje suksesin në profesion dhe të gjitha aspektet e tjera jetësore. Ruaje shoqërinë me miqtë pozitivë dhe inkurajues, ngadhënje ndaj gjërave prej të cilave ke frikë të ballafaqohesh me to. Dije se nuk do të kuptosh kurrë për një send, se a mund ta realizosh apo jo, nëse nuk tenton.

4- Bëhu përgjegjës në jetë, pranoji të gjitha përgjegjësitë profesionale dhe vetjake. Vendos që të ndryshosh për të mirë. Ji gjithmonë nismëtar, fillo dhe shndërroji idetë e tua në realitet. Mos e fajëso fatin, kohën dhe të tjerët, për shkak të pozitës në të cilën gjendesh.

5- Përcakto objektivat e tua me të rëndësishme personale. Paskëtaj vendos për procedurën e realizimit, duke përcaktuar saktësisht kohën e arritjes së tyre.

6- Ruaje zellin, ngulmin dhe vetëkontrollin. Përqendrohu në realizimin e objektivave esenciale. Punët e vështira ndaji në disa pjesë më të vogla, që ta kesh më të lehtë realizimin e tyre. Sakrifiko dhe shtyji kënaqësitë e tanishme, me qëllim që të arrish përfitime të mëdha në të ardhmen. Ngulmo deri sa të arrish suksesin, rëniet dhe dështimet shihi si

“Dije se nuk do të kuptosh kurrë për një send, se a mund ta realizosh apo jo, nëse nuk tenton...”

përvoja dhe mundësi për të mësuar.

7- Ndërmerr masat e duhura për t'i shndërruar objektivat e tua në realitet. Përcille me kujdes ecurinë e përparimit në drejtim të arritjes drejt objektivave, duke bërë përmirësimet dhe ndërhyrjet e duhura gjatë këtij rrugëtimi.

8- Përparo në artin e sjelljes me të tjerët. Ushtro se si ta shprehësh qartë mendimin tënd nëpër tubime. Mësohu se si t'i dëgjosh të tjerët me vëmendje, duke u përqendruar se çfarë thonë, e jo se në ç'mënyrë e thonë. Ki kujdes që gjuha e trupit tënd të mos jetë në kundërshtim me porositë që jep përmes fjalëve. Sigurohu se e ke kuptuar thelbin e bisedës duke bërë pyetje.

9- Kohën mundohu ta administrosh sa më mirë. Objektivat e tua renditi në bazë të prioriteteve dhe rëndësisë. Zbulo se cilat janë elementet kryesore që ndikojnë në humbjen e kohës tënde dhe largojtu prej tyre. Bëhu i përpiktë, bëje regjistrin ditorë të detyrimeve, që duhen kryer gjatë 24 orëve. Pyete veten vazhdimisht: “Si mund ta shfrytëzosh kohën sa më mirë?”

10- Që në fillim le përshtypje të mirë. Vish rroba të mira dhe ke pamje elegante. Rrobat veshi të atilla që të përshtaten me ambientin e punës, pozitën dhe lëmin ku punon. Ji i përpiktë në takime. Fjalët tua hyrëse le të jenë me ndikim, fol me zë që dëgjohet, fol gjuhë të pastër, duke përdorur shprehje të bukura.

11- Njihe profesionin tënd në mënyrë

të imtësishme dhe të plotë. Kënaqu dhe mburru me punën që bën. Përfito në maksimum nga ambienti yt i punës. Sillu mirë me të gjithë kolegët në punë.

12- Merr vendime të qëlluara në kohën e duhur duke u bazuar në fakte të vërtetuara.

13- Realizo punë me rezultat dhe cilësi të lartë gjatë një kohe të caktuar. Parashikoj problemet dhe të ndërmarrësh hapat konkretë në parandalimin e tyre. Përgatit një regjistër që shqyrton thelbin e vlerës tënde personale e që ndikon në shtimin e kualitetit tënd në mënyrë drastike.

14- Sillu me njerëzit me edukatë dhe respekt. Bëji ata që të ndihen të rëndësishëm. Dhuroju vlerësim të saktë dhe të besueshëm. Falënderoji haptas dhe jepu kritika konstruktive fshehtas. Largoju polemikave të panevojshme dhe komenteve ironike.

15- Gjërat në të cilat i fton njerëzit e tjerë për t'i kryer, së pari bëji vetë. Ruaje besueshmërinë tënde vazhdimisht. Përbushit të gjitha premtimet dhe detyrimet e tua.

16- Kërkoji anët më pozitive tek njerëzit dhe fol vetëm mirë për ta. Secilin konsideroje si rast unik. Bëhu i ngrohtë dhe buzëqeshu të tjerëve.

17- Vendos raporte fitim-fitim (Ti të fitosh po edhe të tjerët të fitojnë). Kërko përfitime reciproke në të gjitha bashkëveprimet e tua me njerëzit. Ndihmoju të tjerëve të përparojnë dhe të përmirësohen.

18- Shfaqi përshtypjet e tua emocionale. Bashkëvepro me të tjerët duke ndjerë çfarë ata ndjejnë. Ruaje gjakftohtësitë, le të jenë emocionet e tua gjithmonë në dobinë tënde.

19- Ndiq mënyrën e shëndetshme e të jetuarit. Mbaje formën e trupit duke u

“Dija dhe mundësia nuk nënkuptojnë asgjë, nëse nuk përfitohet prej tyre në mënyrën e duhur...” ”

marrë së paku 20 deri në 30 minuta në ditë me sport. Programi i ushqimit le të jetë i ekuilibruar. Fli dhe pusho varësisht sa ka trupi yt nevojë.

20- Nxito vazhdimisht ta avancosh veten, ripërtërije veten në aspektin mendor, shpirtëror dhe shoqëror. Ji i hapur ndaj kritikës konstruktive dhe çdo gjëje të re.


Dija dhe mundësia nuk nënkuptojnë asgjë, nëse nuk përfitohet prej tyre në mënyrën e duhur. Shtoji angazhimet e tua, me qëllim që të gdhendësh tipare pozitive në personalitetin tënd, të ndërtosh raporte njerëzore të mira dhe të përmirësosh kryerjen e punëve profesionale. Dije se ti je inkurajuesi më i mirë i vetes.

Ti ke lirinë e zgjedhjes. Mund të mbetesh një person pa synime duke u bërë i kënaqur me gjendjen tënde të mjerueshme, ose të marrësh një vendim të prerë që të bëhesh njeri që i realizon detyrimet e tij në mënyrë të veçantë, duke e avancuar thelbin e vlerës tënde personale. Jeta është xhevahir i çmuar ndaj mos e humb. Jeto jetën me vlerë të lartë të kualitetit personal. ■

PREZANTIM I LIBRIT:

“KITABU TEUHID”

. Shqiptarët, ashtu si dhe shumë popuj të tjerë, që ndër shekuj kanë pasur kontakte të vazhdueshme me Islamin, e kanë humbur gjatë kohës imunitetin ndaj dukurive aq të përhapura dhe aq të imëta të shirkut, si pasojë e humbjes së kontaktit të tyre me dijen burimore



SHKRUAN: GENC PLUMBI

Libri “Mbështetja e të Lavdishmit në shpjegimin e librit të Teuhidit” vjen në gjuhën shqipe në një kohë kur shqiptarët, ashtu si dhe e gjithë bota islame, po vuajnë thellësisht pasojat e një injorance të thellë e të trashëguar, ku në thelbin e saj ka mungesën e njësimit të Allahut. Dhe mungesën e ruajtjes së besimit të paprekur nga mbeturinat e shirkut. Shqiptarët, ashtu si dhe shumë popuj të tjerë, që ndër shekuj kanë pasur kontakte të vazhdueshme me Islamin, e kanë humbur gjatë kohës imunitetin ndaj dukurive aq të përhapura dhe aq të imëta të shirkut, si pasojë e humbjes së kontaktit

t ë tyre me dijen burimore që vjen nga Kurani dhe Suneti i Profetit *sal-lallahu alejhi ue selem*. Në mungesë të dijetarëve dhe thirrësve të mirëfilltë që t’u sqarojnë atyre rrugën e të Dërguarit të Allahut në njësimin e Allahut, që me fillimin e kalbëzimit të parimeve bazë të njësimit të Allahut tek Osmanllinjët, të cilat u pasqyruan në përhapjen e vendeve të shirkut, tyrbeve, adhurimit të varreve dhe

vakëfeve, shqiptarët në pjesën më të madhe të popullatës e humbën sensin e plotë të njësimi, dhe u dhanë pas këtyre dukurive, të cilat në thelb shënojnë shembjen e ndërtesës së Islamit dhe kalbjen e themeleve të besimit –përveç atyre që deshi Allahu-, duke e kthyer fenë në një traditë ku përzihej dashuria për Allahun me mungesën e dijes, ashtu siç thotë Allahu: **“Dhe shumica e tyre nuk besojnë vetëm se duke i shoqëruar Atij shok.”** Jusuf 106.

Ky libër synon t'i rikthejë shqiptarët në thelbin e besimit dhe të thirrjes së të gjithë Profetëve: **“Ne kemi dërguar në çdo popull një të dërguar, që i urdhëron të adhuron Allahun dhe të braktisin tagutët.”** (Nahl 36.)

Autori i librit të Teuhdit, Muhamed ibën Abduluehab Temimi vjen nga e njëjta situatë dhe nga një vend, i cili, edhe pse për shekuj me radhë ka qenë një flamurtar i njësimi të Allahut dhe burimi i Islamit, vërtetoi në mënyrë të prerë se mungesa e theksuar e dijes burimore nga Kurani dhe Suneti i Profetit ka një fund të njëjtë në të gjitha vendet islame, ku janë përhapur dukuritë e shirkut dhe të adhurimit të dikujt tjetër përveç Allahut. Muhamed ibën Abduluehabi u rrit në një ambient, ku të tilla dukuri kishin marrë dhenë, ku numri i njerëzve të dijes po pakësohej, kur njerëzit ishin kthyer në vizitorë të rregullt të varreve dhe tyrbeve, kur umeti islam në përgjithësi po përjetonte një periudhë krize në themelet e besimit të tij për shkak të largimit nga dija e trashëguar nga i Dërguari i Allahut dhe nga vendet e mirëfillta të përcaktuara për adhurim, siç janë xhamitë.

Nga ky këndvështrim them se libri shëron dhe trajton të njëjtat dukuri, të cilat për disa shekuj e kishin kapluar

“...Nga ky këndvështrim them se libri shëron dhe trajton të njëjtat dukuri, të cilat për disa shekuj e kishin kapluar umetin islam dhe që shërimi i tyre i vetëm është rikthimi tek njësimi i Allahut...”

umetin islam dhe që shërimi i tyre i vetëm është rikthimi tek njësimi i Allahut.

Libri ndjek dy metoda kryesore në luftën ndaj këtyre fenomeneve, të cilat burojnë nga praktika e Profetit, alejhi salatu ue selam, në ngulitjen e njësimi të Allahut në zemrat e njerëzve. **Së pari**, paraqitja e argumenteve të padiskutueshëm që Allahu është një i vetëm, se Atij i përket adhurimi dhe krijimi, dhe se Ai gëzon emra dhe cilësi të larta e të plota. Për këtë arsye ky libër i kushton një rëndësi të veçantë fjalës së njësimi (teuhidit) **“La ilahe il-lallah”**, nëpërmjet së cilës mohohen të gjithë zotat e rremë dhe i njihet adhurimi vetëm Zotit të vërtetë, Allahut të Lartësuar. Në pjesën **e dytë** libri trajton ato tema, të cilat prishin dhe kalbëzojnë njësimin e Allahut, nëse njeriu nuk tregohet i kujdesshëm. Kjo pjesë trajton forma dhe mënyra të ndryshme të shirkut, adhurimit dhe madhërimit të ndaluar, që në pjesën më të madhe janë të përhapura në botën islame dhe tek shqiptarët gjithashtu. Ndërkohë libri bën me dije se shumë prej këtyre formave janë aq të fshehura dhe të imta sa shumë njerëz kanë rënë viktimë e tyre ndër shekuj.

Nuk ka dyshim se shembulli më i mirë në luftën ndaj shirkut dhe fenomeneve të tij janë profetët, nga të cilët mësohen edhe format e mënyrat e duhura për ta luftuar këtë dukuri, duke përfunduar me shembullin më të mirë, të Dërguarin e Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem*, i cili iu la trashëgim ndjekësve të tij ilaçin më të mirë ndaj sëmundjes së shirkut.

Ky libër është i pajisur me shpjegimet e sakta dhe tërheqëse të dijetarit të madh Abdurrahman ibën Hasan Alu Shejhut, i cili në pjesën më të madhe të rasteve është argumentuar në shpjegimin e tij me fjalët e dijetarëve të mëdhenj të Islamit, siç është Shejhulislam Ibën Tejmije, nxënësi i tij Ibën Kajim el Xheuzije, në tefsir me fjalët e Ibën Kethirit dhe Abdullah ibën Abasit, Hafidh ibën Haxherit dhe të shumë kolosëve të dijes islame. Gjithashtu shpjguesi ka dhënë referenca për hadithet e përdorura si argumente nga Muhamed o Abduluehabi duke treguar edhe gradën e saktësisë së tyre. Çdo temë e këtij libri përfundon me disa dobi të zgjedhura shkurtimisht nga autori i librit të Teuhidit, për ta bërë temën më të lehtë për t'u mbajtur mend nga lexuesi. Gjithashtu ajo që është tërheqëse në këtë libër janë jetëshkrimet dhe disa informacione që jepen për transmetuesit e haditheve, për kolosët e hadithit apo për historitë që lidhen me transmetimet e haditheve, ku bëjnë pjesë një numër i madh i ociaiz, tabi'inëve dhe tabi tabi'inëve. Kjo e ndihmon lexuesin që të njihet më mirë me hadithin dhe transmetuesit e tij. Gjithashtu libri është i pajisur me shembuj nga jeta e përditshme dhe shembuj të freskët nga jeta e trazuar e ocia islam, që kanë të bëjnë në mënyrë të

drejtpërdrejtë me dukuritë e shirkut dhe format e tij, të cilat fatkeqësisht kanë depërtuar thellësisht në popujt muslimanë, të shoqëruara këto me dëshmitë e dijetarëve më të mëdhenj të kohës.

Libri është i pajisur edhe me poshtëshënime të dijetarit Muhamed el Fikijut, të shoqëruara me disa poshtëshënime të dijetarit të mirënjohur Abdulaziz ibën Baz, të cilat ia shtojnë dobinë e këtij libri dhe bukurinë e tij.

Libri është i përbërë nga 63 kapituj afërsisht, të cilët trajtojnë tema të rëndësishme të njësimi të Allahut, siç është: Kuptimi i Teuhidit dhe i adhurimit, kuptimi i shprehjes La ilahe il-lah Muhamedun resulullah, qëndrimin e Allahut mbi Arsh, kuptimi i shprehjes: Isai është rob i Allahut, i dërguari dhe fjala e Tij; kuptimi i shprehjes: Ibrahim i ishte një umet; kush janë ata që do të hyjnë në Xhenet pa llogari, frika nga shirkut, vlera e udhëzimit, kthimi i priftërinjve dhe murgjve në zota, dispozita e nuskave, hajmalive dhe rukjes; therja për dikë tjetër përveç Allahut, zotimi për dikë tjetër përveç Allahut, kërkimi i ndihmës prej dikujt tjetër përveç Allahut, respekti ndaj Profetit pa e tepruar, ndërmjetësimi, teprimi me profetët dhe njerëzit e mirë, shkaqet e kufrit, mallkimi i çifutëve dhe i krishterëve, grupi i ndihmuar, magjia, llojet dhe dispozita e saj; fallxhorët dhe parashikuesit, kërkimi i fatit me ogur, kërkimi i shiut nga yjet, dashuria dhe urrejtja për hir të Allahut, humbja e shpresave nga mëshira e Allahut, syefaqsia, mohimi dhe devijimi në emrat dhe cilësitë e Allahut, caktimi dhe paracaktimi i Allahut, betimi në emër të

dikujt tjetër përveç Allahut dhe shumë tema të tjera të dobishme.

Herë pas here libri trajton edhe problemin e shumë grupeve dhe rrymave, të cilat kanë qëndrimet e tyre të shtrembëta në lidhje me emrat dhe cilësitë e Allahut dhe me shumë tema të Teuhidit, duke iu kundërpërgjigjur me argumente dhe prova të qarta nga libri i Allahut, Suneti i Profetit *sal-lallahu alejhi ue selem* dhe deklaratat e muslimanëve të brezave më të mirë.

Në përgjithësi ky libër përbën një udhërrëfyes të mirë dhe të dobishëm për thirrësit, të cilët kanë dëshirë dhe vullnet për të ndryshuar gjendjen e muslimanëve në trojet shqiptare, duke debatuar në mënyrën më të mirë dhe duke u pajisur me argumentet e nevojshme për të luftuar çdo dukuri negative që vihet re në fushën e njësimit të Allahut. Ky libër tregon në mënyrë shumë përmbledhëse urtësinë profetike për të nxjerrë njerëzit nga errësira e kufrit në dritën e besimit. Në të çdo thirrës musliman do të gjejë materialin e nevojshëm për të debatuar dhe sqaruar çdo dyshim apo shpifje që hidhet mbi temën e teuhidit nga keqdashës dhe njerëz të paditur, të cilët janë rritur dhe edukuar në mungesë të plotë të dijes së pastër islame dhe larg traditës profetike, të ndikuar nga hijet dhe hamendjet e nxitura nga shejtani rreth njësimit të vërtetë dhe domosdoshmërisë së pastrimit të shpirtit nga mbeturinat e shirkut.

Një veçori tjetër e librit është shpjegimi i tij pjesë-pjesë, gjë e cila i jep mundësinë mësuesve të fesë dhe thirrësve që ta kenë më të lehtë përgatitjen e lëndës për mësim, hutbe, ligjërata apo këshilla javore.

Gjithashtu libri i jep mundësinë masës dhe mësuesve të fesë që t'i mësojnë temat e Teuhidit nga çështjet thelbësore dhe të thjeshta, deri tek ato më të ndërlikuarat pa i harruar ato, si dhe nxënësit e rinj do ta kenë më të thjeshtë për të memorizuar temat dhe argumentet e shënuara.

Libri **“Mbështetja e të Lavdishmit në shpjegimin e Librit të Teuhidit”** vjen në vazhden e librave të tjerë në temën e Teuhidit dhe Akides, duke plotësuar kështu librarinë personale të çdo besimtari me një manual të rëndësishëm të thirrjes në rrugën e Allahut dhe me një udhërrëfyes të dobishëm për një familje besimtare, që synon të edukohet me besimin e pastër dhe burimor, për të siguruar kështu suksesin në këtë botë dhe në botën tjetër. Gjithashtu ky libër plotëson nevojën e madhe të muslimanëve shqiptarë për të njohur nga afër dhe në thellësi çështjet e Teuhidit dhe Akides, të cilat përfaqësojnë padyshim varkën e shpëtimit nga kurthet e shejtanit dhe zemërimi i Allahut, si dhe për të rikthyer umetin e muslimanëve në kohët e forcës dhe të krenarisë pasi të ketë hedhur pas shpine kohët e injorancës, shirkut, kufrit dhe largimit nga rruga e drejtë e Allahut.

E lus Allahun e Lartësuar të sjellë dobi për muslimanët nga ky libër dhe t'i mbështesë ata në njohjen e fesë së tyre të pastër. Vërtet, Ai është i Plotfuqishëm për këtë. ■

KUSH I EDUKON FËMIJËT TANË



Me keqardhje konstatoj se realiteti është i hidhur. Shumë prindër nuk kujdesen për edukatorët e fëmijëve të tyre. Familja, e cila duhet të jetë bartëse e edukimit, me sa duket po e humb luftën me mediet, të cilët dalëngadalë po kthehen në (ç)edukues të vërtetë

SHKRUAN: TALHA KURTISHI

Çdo pyetje kërkon edhe përgjigjen e saj. Këtë pyetje çdo prind duhet t'ia parashtrorë vetes. Një pyetje që shkakton dhimbje, dëshpërim, gëzim dhe shpresë, për çdokënd sipas realitetit të tij. Është një pyetje, e cila nuk pranon vonimin e përgjigjes e as që e toleron mosangazhimin për ndryshim të gjendjes dhe edukim të mirëfilltë. Pyetja në fjalë

është: kush i edukon fëmijët tanë? Vëlla i dashur dhe motër e nderuar, prindër të ardhmërisë së këtij umeti, a ia keni parashtruar vetes këtë pyetje? Edukimi i fëmijëve a është në listën e prioriteteve tona, që duhet t'i kryejmë me përkushtim e me zell, apo frytin e zemrës tonë dhe shpresën për shpërblime pas vdekjes ia kemi falur atij nga i cili nuk pritet asgjë e mirë, të largët i cili nuk i mëshiron e as që i drejton në rrugën e udhëzimit?! Këtë pllakë të bardhë, e cila ka lindur në Islam të pastër si duhet ta trajtojmë? A e

zbatojmë ajetin, i cili na urdhëron qartë **ta ruajmë veten dhe familjet tona nga zjarri i xhehenemit** dhe hadithin, i cili thekson përgjegjësinë tonë për familjen dhe fëmijët tanë duke thënë **çdokush është bari dhe çdokush do të përgjigjet për kopenë e tij?** Apo pa u angazhuar fare rreth tyre do të lejojmë që dikush tjetër të shkruajë mbi atë pllakë dhe të edukojë gjenerata të kopjeve të bastarduara të perëndimit, që nuk e njohin të mirën e as që e mohojnë të keqen, që vrapojnë pas epsheve, që pasojnë vlera të rrejshme dhe që shkatërrojnë ardhmërinë e familjes, si boshti i çdo shoqërie të shëndoshë. Me keqardhje konstatoj se realiteti është i hidhur. Shumë prindër nuk kujdesen për edukatorët e fëmijëve të tyre. Familja, e cila duhet të jetë bartëse e edukimit, me sa duket po e humb luftën me mediumet, të cilët dalëngadalë po kthehen në (ç)edukues të vërtetë të fëmijëve tanë. Televizioni, interneti, lojërat kompjuterike dhe mediumet e shkruara kanë zëvendësuar familjen dhe shkollën në edukimin e fëmijës.

Akademia amerikane për psikiatri fëmijërore në studimin e saj rreth ndikimit të muzikës në sjelljen e fëmijëve dhe adoleshentëve ka vërejtur këto tipare të muzikës (e cila dominon në mediumet) së preferuar nga fëmijët dhe adoleshentët:

Droga dhe alkooli glorifikohen, vetëvrasja përmendet si alternativë dhe zgjidhje, dhuna dhe format më të shëmtuara të seksit si sadizmi, mazohizmi, incesti promovohen si sjellje e rëndomtë.

Afro 80% prej fëmijëve që kanë qasje në internet e shfrytëzojnë atë pa kontrollin e prindërve. 60% prej tyre janë ballafaquar me materiale pornografike, materiale që promovojnë dhunë, urrejtje, izolim e

kështu me radhë. Nëse këtij realiteti i bashkëngjisim edhe faktin e mospërputhjes mes interesave edukative të familjes dhe asaj që shfaqet si model në mediumet, atëherë na qartësohet realiteti që përshkruhet me dy fjalë; shpërbërje dhe humbje. Psikologët muslimanë duke folur për realitetin e hidhur, si shkaqet kryesore të shpërbërjes së personalitetit tek fëmijët dhe adoleshentet përmenden:

Edukimi kontradiktor, familja po largohet më tepër dita-ditës nga jeta e fëmijës dhe vendin e saj po e zënë mediumet, të cilët janë bërë domosdoshmëri e jetës, si ajri dhe uji për fëmijët e këtij shekulli. Këto medime shfrytëzohen:

Për largimin e fëmijëve nga identiteti thelbësor i tyre, Islami.

Për imponimin e kulturës së importuar, e cila në shumë gjëra kundërshton bazat e besimit Islam dhe sjelljen Islame.

Promovojnë pasimin e modeleve jo islame që përhapin antivlera.

Vetëdija e dobët e prindërve për nevojat e fëmijëve të tyre, si pasojë e mosinteresimit dhe e mosnjohjes së nevojave të fëmijëve sipas moshës së tyre.

Mosha e fëmijës, dallimet në aftësi dhe prirje si problem në veti. Shumë prindër nuk arrijnë t'i zbulojnë aftësitë e fëmijëve të tyre, si dhe prirjet që kanë ata e pastaj kjo gjë rezulton me imponimin e drejtimeve të papëlqyera dhe zhgënjimin tek fëmija.

Mungesa e edukimit praktik dhe dallimi shpeshherë i madh mes fjalëve dhe veprave. Fëmija si kopjues i prindërve shpeshherë has në kundërthënie mes fjalëve dhe veprave, që pastaj ndikojnë në

“Rikthimi i krenarisë së Umetit fillon aty ku jeton ti, në shtëpinë tënde...”

humbjen e besimit dhe krijimin e një personaliteti të dyfishtë.

Koha e gjatë e harxhuar para mjeteve të komunikimit virtual shkaktojnë probleme në ocializmin e fëmijëve. Kjo gjë manifestohet me mbyllje në vetvete, probleme të vëmendjes dhe të memories. Sipas një studimi pas shikimit të televizorit për pesë minuta trurit i nevojitet një orë e gjysmë për ta kthyer në gjendje normale në të cilën vëmendja dhe mësimi bëhen të mundshëm.

Idealja që promovohet nëpër medime shpeshherë është e paarritshme për fëmijën e rëndomtë. Kjo shkakton humbjen e vetëbesimit dhe mbjelljen e ndjenjës së inferioritetit.

Reklamat si mjet i përhapjes së kulturës së konsumit (identifikimi i lumturisë personale me konsumimin e të mirave materiale). Si pasojë e reklamave tek fëmija krijohen standarde të veshjes, ushqimit, lodrave që jo vetëm janë të dëmshme për aspektin edukativ (këmbëngulet në kopjim dhe përkufizohet kreativiteti), por edhe për shëndetin psikofizik të fëmijëve (gjenerata e fëmijëve të hamburgerit dhe koka-kolës).

Largimi nga ky realitet nënkupton kthimin në bazat e edukimit Islam e që janë:

Sinqeriteti dhe përkushtimi i plotë në edukimin e fëmijëve tanë.

Zbatimi i Islamit në vetë-identifikim dhe sjellje, ose e thënë ndryshe edukimi me sjellje shembullore.

Theksi të vihet në rrënjëzimin e parimeve të Imanit dhe Islamit tek fëmija.

Kultivimi i vlerave islame dhe identifikimi i fëmijëve tanë me këto vlera.

Kujdesi ndaj moshës, aftësive dhe prirjeve që kanë fëmijët.

Kreativiteti dhe angazhimi në gjetjen e alternativave, që do të zëvendësojnë dominimin e medimeve joislame në edukimin e fëmijëve tanë, e kështu me radhë.

Është fakt i pamohueshëm se edukimi i mirëfilltë është rrugë e gjatë dhe plot sfida e rreziqe. Nëse ne nuk do të marrim iniciativën dhe nuk do të angazhohemi në edukimin e gjeneratave të ardhshme, atëherë çfarë të ardhme duhet të presim. Pse përkrah pasivitetit tonë, ne duhet ta ngremë gishtin e akuzës e ta drejtojmë tek të tjerët. Ne jemi ndërtuesit e ardhmërisë të Umetit tonë. Rikthimi i krenarisë së Umetit fillon aty ku jeton ti, në shtëpinë tënde, me përkushtimin dhe angazhimin për edukim të amanetit tonë, fëmijëve tanë. Mos e vono rikthimin e krenarisë. Allahu është Ndihmësi i besimtarëve. ■



A I NJEH DIJETARËT



I ngriti Allahu dijetarët në këtë botë me dituri, njerëzit i duan dhe i respektojnë, mbliidhen rreth tyre, fjalët e tyre zënë vend në zemrat e tyre, pa pasur nevojë t'ju japësh njerëzve pasuri apo t'ju kryesh shërbime

SHKRUAN: BASHKIM BAJRAMI

Dituria është amanet i madh, përgjegjësi madhështore dhe fisnike, me të përcillet porosia e Allahut, u paraqiten argumentet robërve të Tij. Nëpërmjet saj sa njerëz ka udhëzuar Allahu me dituri prej devijimeve, e sa i ka nxjerrë prej errësire në dritë, e sa sy kanë lotuar për Allahun, e sa

zemra janë përkushtuar dhe janë thyer para Krijuesit të tyre.

Dituria e shariatit është drita e Allahut, udhëzimi i Allahut, mëshira e Tij për këtë njerëzim. Kush e ka ndjekur këtë rrugë përfundimi i tij ka qenë në kënaqësinë e Allahut dhe xhenetin e Tij. Prej robërve më të dashur tek Allahu janë dijetarët, si dhe i dalloi ata duke i bërë trashëgimtarë të Pejgamberëve. Allahu i Lartësuar thotë në

librin e Tij fisnik: **“Thuaj: A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?”** Zumer, 9. Ibën Kethiri komenton: “Nuk janë të barabartë ata që i nënshtrohen vetëm Allahut me ata që i bëjnë shokë Atij-shirk.” Imam Taberiu thotë: **“A janë të barabartë ata që dinë** - që për adhurimet e tyre shpërblehen nga Zoti i tyre dhe ndëshkohen për mëkatet, **dhe ata që nuk dinë** - nuk presin shpërblim për veprat e mira dhe as ndëshkim për mëkatet, për këtë ata nuk janë të barabartë.” Ndërsa Imam Kurtubiu thotë: “Nuk barazohet i nënshtuar ndaj Allahut me mëkatarin.

“A janë të barabartë ata që dinë. Ata që dinë janë ata që kanë përfituar nga dituria dhe kanë punuar me të, **dhe ata që nuk dinë** janë ata që nuk kanë përfituar nga dituria dhe nuk kanë punuar me të.”

Nuk barazohet dijetari me injorantin, sikurse nuk barazohet i devotshmi me mëkatarin, po as muslimani me qafirin, i cili beson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe tjetri që e mohon Allahun dhe Ditën e Fundit.

Dijetarin që Allahu e ka furnizuar me dituri dhe e njuh Krijuesin e vet me emrat dhe cilësitë e Tij, ligjet e Tij, urdhrat dhe ndalesat e Tij nuk mund të krahasohet me atë që nuk është dijetar, edhe pse është besimtar dhe i devotshëm, ka një dallim të madh mes atyre të dyve, sa lindja me perëndimin.

Dijetari gjithashtu nuk krahasohet me jobesimtarin, çifutin apo të krishterin, siç e përmend Allahu në Librin e Tij: **“Ata dinë vetëm anën e dukshme të kësaj jete, ndërsa për jetën tjetër janë të pakujdesshëm.”** Rrum, 7.

Kështu ata kanë vetëm njohuri për gjërat e dynjasë, ndërsa nuk kanë dituri mbi Allahun dhe ndaj Ditës së Kijametit janë të pakujdesshëm, nuk e besojnë. Pra, jobesimtarët kanë njohuri për tregti, bujqësi, ndërtime, por mbi fenë e Allahut janë injorantë.

Shejh Sefer Havali thotë në lidhje me këtë

“Vdekja e njëmijë njerëzve që bëjnë adhurim është më e lehtë se vdekja e një dijetari...”

ajet: “Nuk barazohen edhe kafshët, nuk është njësoj qeni i stërvitur (i mësuar) me atë jo të stërvitur. Allahu i bëri qentë të felliqët, saqë nëse lëpin qeni në një enë duhet të pastrohet shtatë herë, në të parën me dhe’, ndërsa nëse qeni i stërvitur kapë gjahun për ne, lejohet ta hamë gjahun, gjë që nuk lejohet nëse të njëjtën e bën qeni i pastërvitur (i pamësuar), siç e ka përmendur në suren Maide, ajeti 4.

E çfarë do të thuash për njeriun kur ta përfitojë diturinë? Ai është krijesa më e nderuar dhe më e ngritur tek Allahu, që e nderoi atë me dituri dhe e ngriti në shkallët më të larta në dynja dhe në ahiret, siç thotë Allahu në Kuran: **“Allahu do t’i ngrëjë në shkallë të lartë ata midis jush që besojnë dhe që iu është dhënë dija.”** Muxhadele, 11.

I ngriti Allahu dijetarët në këtë botë me dituri, njerëzit i duan dhe i respektojnë, mblidhen rreth tyre, fjalët e tyre zënë vend në zemrat e tyre, pa pasur nevojë t’ju japësh njerëzve pasuri apo t’ju kryesh shërbime, por Allahu e ka futur dashurinë për ata në zemrat e njerëzve, edhe pse nuk janë prej familjeve autoritative, apo me pozita, apo të pasur, por thjesht Allahu i ka ngritur me dituri, se nuk janë të barabartë me të tjerët.

Omeri radiallahu anhu kishte caktuar përgjegjës të Mekës, Nafi ibën Huzejmen. Kalifi duke udhëtuar për në Meke takohet me Nafiun rrugës dhe e pyet kë ke lënë zëvendësin tënd në Meke. Nafiu i përgjigjet: Ibën Ebza,- e pyet Omeri kush është ai, ia kthen: Shërbëtori jonë.- Omeri e pyet: Ke lënë zëvendës shërbëtorin mbi parinë e kurejshëve? Ai i thotë: Po, o Prijësi i

Besimtarëve, se ai lexon Kuranin dhe i njeh farzet e Allahut.- Këto ishin tiparet e këtij shërbëtori. Omerit iu kujtua fjala e Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem*, se Allahu i ngre disa me këtë Kuran e disa i ulë. Po, Allahu i uli e i poshtëroi të parët e kurejshëve, si Ebu Xhehlin, Ebu Lehebin, Uelid ibën Mugiren etj., dhe ngriti disa të tjerë si Suhejb Rumiun, Bilal Habeshiun dhe Selman Farisiun.

Gjithashtu na bëhet e ditur me ajetin tjetër, se nuk janë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë fjala e Allahut, ku i drejtohet Pejgamberit të Tij **“Dije, se vërtetë nuk ka të adhuruar tjetër pos Allahut, dhe kërko falje për mëkatet e tua.”** Muhamed, 19.

Imam Buhariu në Sahihun e tij e fillon kapitullin e dijes para fjalës dhe veprës, duke u bazuar në ajetin paraparak. Ngase Allahu fillimisht e urdhëroi të dijë para se të punojë, sepse po të punosh pa dituri nuk ka vlerë puna, si dhe shkak i devijimit të krishterëve është dituria e pakët, sepse punonin pa dituri dhe kështu devijuan.

E shohim se si Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* i bënte Allahut dua që t’ia shtonte diturin, duke thënë: **“O Zot më shto diturinë.”**

E si mund të jenë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë? Ndërkohë që Allahu iu dha prej mirësive të Tij, derisa u bënë robër të devotshëm e të lumtur, i lavdëroi në Librin e Tij, i respektoi dhe i nderoi duke i dalluar në fjalët e Tij, ku thotë: **“Me të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët.”** Fatir, 28. E kanë këtë frikë nga Zoti i tyre, sepse ata e njohin madhësinë e Allahut, mëshirën e Tij si dhe dënimin, i pajisi Allahu melaqet dhe pejgamberët me frikë-respekt (takva) ndaj Allahut, pastaj edhe dijetarët. E si mund të barazohet me një të paditur, i cili nuk e njeh madhësinë e Krijuesit të vet e as premtimin e Tij.

Dijetarin e njohur Shabiun e pyetën një herë: Kush është dijetar?- Ai iu përgjigj:

Dijetar është ai që ia ka frikën Allahut. E nëse ka dije e nuk ka frikë ndaj Allahut dituria e tij do të jetë argument kundër tij, ky është dijetar vetëm i gjuhës e dituria nuk i ka mbërritur në zemër. E sheh se nuk e vëren ushqimin, a është hallall apo haram, po as në të holla, se nga i përfiton, i përshtatet rrethit e ambientit e jo fesë së Allahut e ky nuk është dijetar.

Allahu përsëri na tregon në ajetin tjetër se nuk janë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë, ku thotë: **“Allahu dëshmon, e po ashtu edhe engjëjt, edhe njerëzit e dijes, se nuk ka zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Tij.”** Ali Imran, 18.

Ky ajet dëshmon për vlerën dhe pozitën që kanë dijetarët, që Allahu e krahason dëshminë e Vet dhe të melaqeve, me dëshminë e dijetarëve e jo me dëshminë e njerëzve, që kanë pozita e pasuri.

İbën Kajimi lidhur me këtë ajet thotë në librin e tij Miftah Daris Seadeh: **“Në marrjen e dijetarëve për të dhënë dëshminë më të madhe, e që është të qenit e Allahut Një dhe i Vetëm vërehet vlera e dijes dhe e dijetarëve nga disa aspekte :**

Ata janë dalluar nga njerëzit e tjerë për të dëshmuar. 2- Allahu e ka barazuar dëshminë e tyre me dëshminë e Tij. 3- Allahu e ka barazuar dëshminë e tyre me dëshminë e melaqeve. 4- Kjo nënkupton garanci për fenë, besimin dhe sinqeritetin e tyre. 5- Allahu i ka cilësuar ata si të dijshtëm.

Për vlerën që ka dijetari na tregon edhe Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* në hadithin që e përcjell Ebu Derda, të cilin së bashku me komentin e tij mund ta lexoni te rubrika e hadithit.

Omeri radiallahu anhu thotë: **“Vdekja e njëmijë njerëzve që bëjnë adhurim është më e lehtë se vdekja e një dijetari.”**

İbën Kajimi në lidhje me fjalën e Omerit thotë, se dijetari shkatërron kurthet e shejtanit me atë që ndërton ai me diturinë

dhe udhëzimin e tij, ndërsa ai që bën vetëm adhurim është vetëm për veten e vet. Dijetari u mëson njerëzve pendimin, mënyrën si ta adhurojnë Allahun, hallallin dhe haramin, u tregon atyre rrugën e xhenetit dhe u tërheq vërejtjen nga zjarri i xhehenemit, në krahasim me adhuresin e paditur, i cili e bën adhurimin vetëm për veten e vet e për këtë dijetari e ka peshën dhe vlerën më të madhe dhe nuk mund të barazohet me atë që nuk ka dije.

Shejh Bishër el Bishër përmend tiparet e dijetarëve:

1- punojnë me atë që dinë, e në këtë është bereqeti, të punosh me diturinë që ke përfituar, dituria është si pema e puna janë frytet e saj, ndërsa ata që kanë dituri e nuk punojnë do të ndëshkohen Ditën e Gjykimit.

2- Kanë frikë ndaj Allahut, sepse e njohin Madhështinë e Krijuesit.

3- Janë të përgjegjshëm ndaj ditorisë, kur përmendin diçka tregojnë se fjala e kujt është e nuk i vjedhin fjalët e të tjerëve dhe t'ia dedikojnë vetes.

4- Janë modestë, nuk janë mendjemëdhenj.

5- Janë të kujdesshëm ndaj kohës, e dinë vlerën e saj dhe e dinë se nuk blihet me pasuri; e kalojnë kohën me lexim, adhurim, davet, e nuk e humbin kohën kot.

6- Janë krenarë me diturinë, të pasur në zemër nuk e lakmojnë pasurinë e dynjasë.

Shejh Muhamed Muhtar Shenkiti dhe shejh Bishër el Bishër përmendin detyrimet e njerëzve ndaj dijetarëve:

1- T'i respektojnë dhe t'i nderojnë dijetarët.

2- Të paraqiten herët në tubimet e dijes.

3- Të nxënë dituri pranë tyre e sidomos t'i marrin fetvatë gjatë sprovave, që e godasin këtë umet e jo nga ata që nuk janë dëshmuar se janë dijetarë.

4- Të rrinë afër dijetarëve dhe të ulen pranë, si nxënës.

“Ata i kanë lënë gratë dhe fëmijët si të ishin të veja dhe fëmijët pa prind, vetëm për të na ndriçuar rrugën drejt Allahut dhe xhenetit të Tij...”

5- Të tregohet edukatë kur të flitet dhe kur të pyeten ata.

6- T'i mbrosh dijetarët dhe të mos lejosh që në praninë tënde të njolloset nderi i tyre.

7- Të mos i dëmtosh, ngase janë miqtë e Allahut.

8- Të bësh dua për ta, sepse mos prania e dijetarëve në atë vend errësohet dhe shejtanët i devijojnë njerëzit nga rruga e Allahut.

9- Heshtja dhe mos nxitimi për të folur përpara tyre në tubime.

10- Nëse janë të vdekur të bësh dua që Allahu t'i mëshirojë dhe t'i përmendësh për mirë.

Prandaj ki frikë Allahun e respektoji dijetarët, se këta janë trashëgimtarët e pejgamberëve, sepse Allahu na ka nderuar me ta. Ata kanë sakrifikuar shumë në kohë, pasuri, kanë udhëtuar me muaj, kanë ndenjur të etur e të uritur, sytë e tyre janë mbyllur pak, po edhe dora e tyre nuk ka pushuar duke shkruar, këmbët e tyre janë ënjtur duke ecur, i kanë lënë gratë dhe fëmijët si të ishin të veja dhe fëmijët pa prind, vetëm për të na ndriçuar rrugën drejt Allahut dhe xhenetit të Tij.

O musliman kape gjuhën e mos fol kundër tyre, se mishi i tyre është i helmuar dhe dije se përfundimi yt do të jetë i keq.

Kanë thënë disa prej dijetarëve: “Shihe tjetrin nëse ka një zemër të sëmurë, kur ai i nënçmon dhe i përbuz dijetarët.” ■

NE JEMI UMETI I “IKRE-S”


SHKRUAN: LULZIM SUSURI

Nga Ebu Derdai, Allahu qoftë i kënaqur me të na përcillet, se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, duke thënë:

“Kush merr një rrugë për të kërkuar dituri, Allahu për hir të asaj rruge do t’ia

Nga Ebu Derdai, Allahu qoftë i kënaqur me të na përcillet, se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë:

“Kush merr një rrugë për të kërkuar dituri, Allahu për hir të asaj rruge do t’ia lehtësojë rrugën për në xhenet. Për kërkuesin (nxënësin) e dijes melekët i shtrijnë krahët nga kënaqësia me punën e tij. Për dijetarin kërkojnë falje çdo krijesë që ekziston në qiej dhe në tokë deri edhe peshqit në det. Vlera e dijetarit ndaj adhuresit të paditur (jo dijetarit) është si vlera e hënës (së shndritshme) ndaj planetëve të tjerë. Dijetarët janë trashëgimtarë të profetëve, e këta të fundit nuk kanë lënë trashëgimi, as dinarë e as dërhëm, por trashëgimia e tyre është dija, të cilën kush ka fatin ta marrë ai ka arritur të marrë gjënë më të vlefshme”.



lehtësojë rrugën për në xhenet. Për kërkuesin (nxënësin) e dijes melekët i shtrijnë krahët nga kënaqësia me punën e tij. Për dijetarin kërkojnë falje çdo krijesë që ekziston në qiej dhe në tokë deri edhe peshqit në det. Vlera e dijetarit ndaj adhuresit të paditur (jo dijetarit) është si vlera e hënës (së shndritshme) ndaj planetëve të tjerë. Dijetarët janë trashëgimtarë të profetëve, e këta të fundit nuk kanë lënë trashëgimi, as dinarë e as dërrhem, por trashëgimia e tyre është dija, të cilën kush ka fatin ta marrë ai ka arritur të marrë gjënë më të vlefshme”.

Zinxhiri i hadithit:

Hadithin e përcjell Ebu Derdai, Allahu oftoftë i kënaqur me të.

Kurse atë e shënojnë në librat e tyre imam Ahmed i në Musned, 5/197 nr. 22058, Ebu Davudi, nr. 3641, Ibën Maxhe, nr. 223, Nesaiu, nr. 158, Abdurrezaku në “Musanef”, nr. 795, Ibën Huzejme, nr. 193, Darimiu, nr. 363, Ibën Hibani, nr. 85, Taberani në “Kebir”, nr. 7352... ndërsa Tirmidhiu e transmeton vetëm fjalinë e dytë (Për kërkuesin (nxënësin) e dijes melekët i shtrijnë krahët nga kënaqësia me punën e tij) me nr. 3535, kurse hadithin me nr. 2646, i cili ka të njëjtin tekst (pra, vetëm fjalinë e lartpërmendur) e transmeton nga Ebu Hurejre, radijallahu anhu.

Ky hadith në transmetimet e lartpërmendura thuhet tek të gjithë përmendet me të njëjtin tekst e tek disa të tjerë, siç ishte rasti tek Tirmidhiu përmendet vetëm fjalia e dytë e tij. Rreth saktësisë së hadithit të lartpërmendur ka mjaft fjalë. Disa nga ata e saktësojnë vetëm fjalinë e dytë të tij, disa të tjerë gjysmën e parë të hadithit, kurse për atë të dytën

thonë se është shtojcë e disa transmetuesve. Por mendimi më i saktë është ai, se hadithi në fjalë është i tëri fjalë e Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Kurse sa i përket saktësisë së tij, ata që e pranojnë si fjalë profetike pastaj ndahen në dy mendime rreth saktësisë së tij, të parët mendojnë se është hadith sahih (i saktë), kurse pala tjetër e konsideron hadith hasen (të mirë), sido që të jetë sipas gjykimit të të dy palëve hadithi i lartpërmendur konsiderohet argument në fe dhe si i tillë nuk lejohet të refuzohet. Hadithin e saktëson Hakimi, Ibën Hibani, Albani etj.¹

Komenti i hadithit:

Hadithi i lartpërmendur flet për dy lloj njerëzish, apo e thënë ndryshe gërsheton në vetvete dy kategori njerëzish, e para: nxënësit e dijes dhe e dyta: dijetarët. Në pjesën e parë të hadithit inkurajohen nxënësit e dijes që të trasojnë dhe ta vazhdojnë këtë rrugë mjaft të vështirë dhe të gjatë, por shumë të shenjtë dhe të vlefshme. Kurse në pjesën e dytë Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, tregon vlerën e dijetarëve, vlerë kjo e cila pas pejgamberllëkut në Islam në rrethana të përgjithshme është vlera apo grada më e madhe, që mund t’i jepet dikujt nga Allahu. Vlera e dijes në fjalët e Allahut dhe të Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, nuk është aspak për t’u habitur. Kjo për arsye se ne në Islam, nëse nuk do të kishim asgjë me çfarë të lavdëroheshim do të na mjaftonte fakti se urdhri dhe fjala e parë që i ka zbritur profetit me të cilën njëherësh atij edhe i erdhi pejgamberllëku ishte fjala: **“Ikre”**, që do të thotë: **“Lexo”**. Pra, ne jemi Umeti i leximit, Umeti i dijes dhe i respektimit të vlerave të saj.

¹ Shih: “Sahih Xhamius Sagir” të Albanit, hadithi nr. 6297.

Fjala profetike:

Kush merr një rrugë për të kërkuar dituri, Allahu për hir të asaj rruge do t'ia lehtësojë rrugën për në xhenet.

Kjo do të thosha se ndodh për disa arsye:

Sepse dituria është adhurim në vetvete, bile shumë i vlefshëm, i cili pa dyshim të afron tek Allahu.

Dija është mënyra më e mirë përmes së cilës pasi ta mësosh do ta kesh më të lehtë ta dish si t'i afrosh xhenetit dhe të futesh në të.

Kjo fjali na jep të kuptojmë se nisja për në rrugë të dijes është njësoj si rruga për xhenet, sepse njeriu që kërkon dituri dhe që e arrin atë pastaj do të jetë në kënaqësi aq të madhe në këtë botë, sikur të ishte në xhenet, e xheneti i kësaj bote është thellimi në dijen, e cila të mëson për Zotin, Profetin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dhe për xhenetin.

Gjithashtu nga fjalia kuptohet sikur rruga e dijes është e ngjitur me rrugën e xhenetit. Prandaj kush e çel atë rrugë (rrugën e dijes) dhe mundohet të ecë sa më shumë në të ai njëherësh e ka shkurtuar largësinë mes tij dhe xhenetit, sepse e ka kaluar një pjesë rruge shumë të gjatë, e cila pa dyshim zgjat me vite të tëra.

Po ashtu rruga e xhenetit është e humbur për shumë njerëz dhe grupi më i sigurt, i cili mund ta gjejë atë janë njerëzit që marrin dije fetare. Kjo është njësoj si me shenjat e vendosura në rrugët tona, të cilat mund t'i kuptojë dhe t'i deshifrojë shumë mirë, ai që ka dije më të madhe rreth tyre dhe është i mirë-informuar. Ky lloj njeriu do të arrijë më shpejt, më lehtë dhe më sigurt në destinacionin e tij të dëshiruar, sepse ka pasur dituri për mënyrën se si arrihet në atë vend. Ashtu edhe nxënia e dijes fetare do të jetë shkaktare për bartësin e saj, që të arrijë sa më lehtë në destinacionin e tij ngase me dijen e tij ka

ditur t'i kuptojë dhe t'i deshifrojë shenjat (rregullat), të cilat i ka vendosur Allahu në rrugën që të shpie për në xhenet.

Fjala e Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*:

“Për kërkuesin (nxënësin) e dijes melekët i shtrijnë krahët nga kënaqësia me punën e tij.”

- Melekët janë krijesa të padukshme për ne, por gjithsesi ne besojmë se ato i shtrijnë krahët e tyre për nxënësin e dijes. Për sa i përket krahëve të melekëve kjo gjë është e vërtetuar me Kuran, se melekët kanë krahë, disa prej tyre dy palë, disa tri e disa të tjerë katër. Kurse Xhibrili, alejhi selam, i ka gjashtëqind palë krahë. Allahu në Kuran thotë: **“Falënderimi i goftë Allahut, Krijuesit të qiejve e të tokës, Sajuesit të engjëjve me nga dy palë, tri palë e katër palë krahë, ndërmjetësues** (midis Tij dhe pejgamberëve). **Ai shton në krijim atë që do, vërtet Allahu ka fuqi për çdo send.”** (Fatir, 1)

- Lind pyetja se si melekët i shtrijnë krahët e tyre për kërkuesin e dijes? Pra, ata i shtrijnë krahët e tyre për të ecur dhe për të qëndruar studiuesit e fesë mbi krahët e melekëve. Kjo jo për hir të emrave të këtyre personave, por për hir të qëllimit dhe punës që janë duke bërë. Sa për ilustrim këtu do të përmend një rast mjaft interesant, i cili ka të bëjë me këtë pjesë të hadithit të Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Këtë rast e përcjell imam Neveviu në librin e tij *“Bustanul arifin”* me zinxhirë të njohur dijetarësh në të cilin ai thotë: “Disa dijetarë duke ecur rrugës në kërkim të dijes panë një njeri që kishte veshur nallane druri nën të cilat kishte vendosur disa gozhda. Të habitur e pyetën atë pse i kishte vendosur gozhdët? Ai ju përgjigj: Që t'i shpoj krahët e melekëve (pasi ju thoni se ato i shtrijnë krahët për juve). Nuk vonoi shumë e ky njeri u paralizua nga këmbët”. Kjo ndodhi

për shkak se ai nuk e besoi fjalën e Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dhe bëri shaka me melekët e Zotit.

- Bazuar në fjalinë e mëposhtme të hadithit mendoj se melekët jo vetëm që vendosin krahët e tyre për të ecur kërkuesit e dijes mbi ta, por këta melek edhe lutën për njeriun. Këtë e bazoj në dy shkaqe: a) për arsye se pasi lutet çdo gjallesë për këtë lloj njeriu, atëherë ata që ia dinë më shumë vlerën dijes janë melekët, prandaj ata përveçse i shtrijnë krahët për kërkuesin e dijes, edhe lutën për të. b) në fjalinë në vazhdim përmendet se për studentin e dijes kërkojnë falje të gjitha krijesat në qiej dhe në tokë, kjo na jep të kuptojnë se ndër gjallesat që jetojnë në qiej dhe në tokë janë edhe melekët.

- A thua melekët veprojnë kështu vetëm me nxënësin, gjatë kohës që është duke kërkuar ai dije, apo edhe me dijetarin pasi ka përfituar shumë dituri nga lëmi të ndryshme?

Në shikim të parë duket se melekët veprojnë në këtë mënyrë vetëm për nxënësin gjatë kohës së kërkimit të dijes, por mendoj se ata vazhdojnë të veprojnë kështu edhe me dijetarët pasi të kenë arritur dituri të mëdha. Këtë që po e them e bazoj në dy shkaqe kryesore:

Për arsye se dijetarët edhe pasi të arrijnë në shkallë të larta të dijes vazhdojnë prapë të mos ndalen së kërkuari dituri deri në vdekje. Bile ka prej tyre që më shumë jepen pas kërkimit të dijes pasi kanë arritur shkallën e dijetarit. Këto që po i them shpesh i kemi hasur edhe tek dijetarët e umetit më të cilët kemi pasur kontakte gjatë jetës sonë nëpër studime.

Nëse melekët kanë këtë respekt për atë që vrapon të mësojë për vete fenë e Zotit, atëherë çfarë mund të bëjnë këta melekë për atë njeri, i cili vrapon apo ecën nëpër faqen e tokës për t'ua mësuar të tjerëve

“...i shtrijnë krahët e tyre për të ecur dhe për të qëndruar studiuesit e fesë mbi krahët e melekëve. Kjo jo për hir të emrave të këtyre personave, por për hir të qëllimit dhe punës që janë duke bërë...”

fenë e Zotit. Dallimi mes këtyre dy grupeve është më se i qartë, sepse dobia e dijetarëve është e dyfishtë, ndaj atij që akoma është duke kërkuar dituri, kështu që edhe respekti i melekëve është më i madh për ta. Allahu e di më së miri!

Fjala e Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*:

“Për dijetarin kërkojnë falje çdo krijesë që ekziston në qiej dhe në tokë deri edhe peshqit në det.”

Tani fillon pjesa e dytë e hadithit, pra, ajo që flet për vlerën e dijetarëve. Këtu do të veçoja disa pika:

Kush janë ata dijetarë që ka si qëllim Profeti, *salallahu alejhi ue selem*, në hadithin e tij? Sipas mendimit të të gjithë dijetarëve të Islamit me emrin dijetarë në këtë hadith kihet si qëllim ata të fesë, pra, dijetarët e Islamit, të cilët ua shpjegojnë dhe ua komentojnë të tjerëve fenë e Zotit.

Me këtë fjali tregohet vlera e madhe e dijes dhe e dijetarëve. Ajo është aq e madhe sa Zoti i ka urdhëruar të gjitha krijesat e Tij kudo qofshin ato, që të kërkojnë falje dhe të lutën për dijetarin. Pra, shumica e këtyre krijesave, edhe pse nuk kanë logjikë, megjithatë Zoti ua ka mundësuar siç di vetëm Ai, që këto krijesa të kërkojnë falje për dijetarët.

Veçimi i peshqve në det na sinjalizon duke na e përforcuar bindjen, se lutje të tilla bëjnë të gjitha krijesat në të tri vendet e mundshme të ekzistencës së tyre; qiell, tokë dhe ujë. Tre vende këto të cilët nuk kanë të katërt. E sikur të mos përmendej edhe deti ndoshta nuk do të na kishte shkuar mendja tek krijesat e tij, apo edhe sikur të ishim kujtuar për ta do të ishim në dyshim, se krijesat e botës së detit, a thua mund të futen në këtë hadith apo jo. Kështu që përmendja e detit në mënyrë të veçantë na e largon këtë dyshim.

Për sa i përket mënyrës se si kërkojnë falje për dijetarin këto krijesa themi se një gjë e tillë për njerëzit është fshehtësi e Zotit, të cilën ne nuk e dimë, por pa kurrfarë dyshimi e besojmë sepse prej rregullave të besimit tonë është edhe rregulli që të pranojmë çdo gjë që na ka ardhur nga Allahu dhe i Dërguari i Tij, duke mos dyshuar aspak në atë që ata dy e përmendin.

Pasi dijetari mundohet t'i shërbejë një kategorie të krijesave (njerëzve), duke ua mësuar fenë e Allahut, atëherë për hir të këtij misioni kaq të madh Allahu atij i vendos nën shërbim të gjitha llojet e krijesave, qofshin ato në qiej, tokë apo det. Kështu që kush i shërben Allahut në një mënyrë të caktuar, sinqerisht për hir të Tij, atëherë Allahu do t'ia kthejë atë të mirë shumë fish.

Nëse ndalemi dhe e analizojmë shkakun pse melekët kërkojnë tek Allahu falje për gabimet e dijetarëve do të kuptojmë fshehtësinë, se forcimi në rrugën e drejtë dhe vazhdimësia në të arrihet vetëm duke qenë i pastër dhe pa gabime para Zotit Fuqiptotë. Zaten një nga shkaqet kryesore për të pasur sukses në punët e ahiretit është largimi nga çdo mëkat i mundshëm, sa më shumë, për këtë shkak edhe njerëzit që kanë pasur shumë pak gabime kanë qenë

profetët, e si rrjedhojë edhe dijetarët që janë trashëgimtarë të profetëve duhet të jenë të tillë. Mirëpo në anën tjetër nga hadithi kuptojmë, se edhe dijetarët janë njerëz dhe nuk janë të mbrojtur nga gabimet, dhe si për çdo njeri edhe për ta gabimi është i mundshëm, sepse pa gabime është vetëm Allahu i Lartësuar.

Fjala e Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem:*

“Vlera e dijetarit ndaj adhuruesit të paditur (jo dijetarit) është si vlera e hënës (së shndritshme) ndaj planetëve tjerë.”

- Kjo për shkak se dituria e hijeshon adhurimin, e ruan atë nga çdo shirk, bidat dhe mëkat, e kështu vazhdon dijetari ta adhurojë Allahun me syçelësi deri në vdekje, duke mos u larguar asnjëherë nga rruga e vërtetë e Tij. Kurse i padituri sado që është adhurues i devotshëm, ai prapë ka mangësi dhe mundësia e tij për të rënë në gabimet e lartpërmendura është gjithmonë e hapur. Në këtë pjesë të hadithit dijetari u krahasua me hënën e shndritshme, e cila përveç që ecën rrugës së saj të caktuar nga Allahu, ajo edhe i bën dritë njerëzve gjatë natës, që ata të mund të ecin rrugës së tyre. Kështu është edhe shembulli i dijetarëve që jo vetëm ecin për vete rrugës së caktuar nga Allahu ata njëherësh edhe të tjerëve ju bëjnë dritë për ta gjetur, apo për ta parë rrugën e drejtë dhe për ta ndjekur atë.

Kurse i padituri u krahasua me planetët e tjerë, të cilët janë në gjendje të ndryshme disa më të mirë e disa më të këqij, disa të ngrirë e disa të zjarrtë, por asnjëri prej tyre nuk shndrit. Kështu edhe i padituri, ai mund të jetë adhurues me gjendje nga më të ndryshmet, mundet edhe të jetë shumë i devotshëm, por assesi nuk mund të jetë shembull për të tjerët, i cili mund të shndritë që t'ua tregojë rrugën njerëzve të tjerë, kjo për shkak se i mungon drita që në këtë rast është dituria.

Fjala e Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*:

“Dijetarët janë trashëgimtarë të profetëve, e këta të fundit nuk kanë lënë trashëgimi, as dinarë e as dërhëm, por trashëgimia e tyre është dija, të cilën kush ka fatin ta marrë ai ka arritur të marrë gjënë më të vlefshme”.

Çdo njeri ka dëshirë të trashëgojë diçka të çmueshme dhe shpesh ndodh që kur iu vdesin prindërit, ndoshta edhe kacafyten për çështje trashëgimie. Por pa dyshim se trashëgimia e vërtetë është ajo që kanë lënë profetët. Dituria përveç që është adhurim ajo është edhe trashëgimi e lënë nga profetët e Zotit, e pa dyshim se profetët janë munduar të arrijnë maksimumin e gjërave të vlefshme e për ta pasi ishte dituria ajo më e dobishmja edhe e grumbulluan rreth vetes. Kurse për sa i përket pasurisë ata e panë se nuk ia vlen të vrapohet pas saj dhe kështu ua shpërndanin të tjerëve në momentin që u binte në duar.

Dituria është gjëja më e vlefshme, të cilën njeriu mund ta marrë nga profetët aq më tepër për vetë faktin se ajo u bart direkt nga Allahu tek profetët e prej këtyre të fundit tek dijetarët, prandaj profesioni i dijetarëve është trashëgimia më fisnike dhe profesioni më i lavdëruar në fytyrë të tokës, sepse dijetarët janë zëvendës të profetëve; pasi në tokë pas Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, nuk ka më profet, por rolin e tyre e luajnë dijetarët dhe ata kanë misionin dhe trashëgiminë, së bashku me përgjegjësinë. Kështu që dijetarët janë me mision profetik në fytyrë të tokës, por jo me të njëjtin titull sikurse ishin profetët.


Për sa i përket krahasimit të dijes me pasurinë, e cila është përmendur kalimthi në hadith nuk do të ndalem shumë për të folur, duke e vlerësuar të parën ndaj të dytës, e kjo për shkak të hapësirës së vogël,

“Në tokë pas Muhamedit, sal-lallahu alejhi ue selem, nuk ka më profet, por rolin e tyre e luajnë dijetarët ...”

por do të përmend vetëm një fjalë të dijetarëve, e cila do të shërbejë si shembull i mirë për të parë dallimin dhe epërsinë e dijes ndaj pasurisë.

Muadh ibën Xhebeli thotë: “Mësoni dije, se mësimi i saj është mirësi, kërkimi i saj iradet, përsëritja e saj tesbih, studimi i saj është xhihad, mësimi i të tjerëve është sadaka, t’ia japësh atyre që e meritojnë është afrim tek Allahu. Dija është rruga, e cila të shpie në shtëpitë e xhenetit, është qetësuese në frikë, shoqëruese në vetmi, bashkëbisedues në mërzë, tregues i rrugës nëpër gëzime, ndihmës në hidhërim. Zbukurimi më i madh, edhe pse ndoshta s’ke të tjera zbukurime, armë kundër armiqve. Allahu me dije ngre njerëz, duke i bërë udhëheqës në mirësi dhe hapat e tyre i pasojnë gjeneratat që vijnë, melekët ua kanë lakmi dhe me krahët e tyre vazhdimisht i përkëdhelin. Për ta lutet çdo gjë e njomë dhe e thatë, peshqit e detit, egërsirat dhe kafshët e tokës. E tërë kjo vlerë për shkak se dija është jetë e zembrës nga injoranca, kandil i syrit në errësi, forcë e trupit nga çdo dobësi. Përmes saj njerëzit arrijnë gradët e të devotshmëve dhe shkallët e larta në këtë botë dhe në botën tjetër. Të menduarit rreth dijes ka shpërblimin njësoj me agjërimin, përsëritja e tij krahasohet me namazin, përmes saj nuk shkëputen lidhjet familjare, me të njihet hallalli dhe harami. Dija është udhëheqës, kurse puna veçse pasues i saj. Atë Allahu ua jep të devotshmëve kurse ua ndalon mëkatarëve”. ■

REPUBLIKA E GUAJANËS



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Emri i plotë: Republika kooperative e Guajanës

Kryeqyteti: Xhorxhtaun

Sipërfaqja: 214, 999 km²

Banorët deri më 2009 : 772.298

Përqindja e myslimanëve: 7.3 %

Gjuha: Angleze dhe gjuhë të tjera të njohura.

Monedha: Dollari i Guajanës (GYD)

Pavarësinë: 26 Maj 1966 (nga Britania)

Anëtar i Kombeve të Bashkuara: 20 Shtator 1966

Anëtar i Konferencës Islamiqe: 1998



DRITON LEKAJ

Republika Ko-operative e Gujanës, dikur e quajtur *Guajana Britanike*, është shteti i vetëm i Komonuelthit¹ në Amerikën kontinentale Jugore. Kufizohet në lindje nga Surinami, në jug dhe jugperëndim nga Brazili dhe në perëndim nga Venezuela, ajo është vendi i tretë më i vogël në Amerikën Jugore.

Është një nga katër territoret jo-spanjolle në kontinent, së bashku me Brazilin (Portugalisht), Surinamin (Holandisht) dhe Guajanën Franceze (Frëngjisht). Emri Guajana rrjedh nga emërtimi i mëparshëm i tërë rajonit, i cili përfshinte Guajanën, Surinamin, Guajanën Franceze dhe pjesë të Venezuelës e Brazilit. Besohet se termi origjinal vjen nga një fjalë e gjuhës “Taino”, që ka kuptimin “toka e ujit me rrjedhje të shpeshtë”.

Guajana e fitoi pavarësinë e saj nga Britania e Madhe më 26 Maj 1966 dhe u bë republikë më 23 Shkurt 1970 dhe ka mbetur si

anëtare e Komonuelthit. Qeveria Britanike dhe Departamenti i shtetit të SHBA-së kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën politike të këtij shteti.

Sa i përket aspektit fetar shumicën prej 57 % të popullsisë e përbëjnë të krishterët si tërësi e pas tyre vijnë Hindusët me 23.4 % dhe muslimanët me 7.3 %. Hinduizmi dominohet nga indianët e ardhur në fillim të shekullit të 19-të, ndërsa muslimanët e parë që shkelën në këtë vend ishin nga Afrika dhe India.

Ekonomia e Guajanës ka pasur një rritje të mirë ekonomike në vitet e fundit dhe është e bazuar kryesisht në bujqësinë dhe industrinë. Ekonomia varet nga eksporti i gjashtë mallrave - sheqerit, arit, boksitit, karkalecave, lëndës drusore dhe orizit - që përfaqësojnë rreth 60% të GDP-së së vendit dhe janë shumë të ndjeshme ndaj kushteve të motit negativ dhe luhatjeve në çmimet e mallrave. ■

¹ Komonuelthi i Kombeve, i njohur zakonisht si ‘Commonwealth’ është një organizatë ndërqeveritare e pesëdhjetë e tre shteteve të pavarura anëtare. Shumica e tyre dikur ishin pjesë e Perandorisë Britanike. Ata bashkë-veprojnë brenda një kornize vlerash të përbashkëta e qëllimesh, siç përshkruhet në Deklaratën e Singaporit. Këto përfshijnë promovimin e demokracisë, të drejtave të njeriut, qeverisjen e mirë, sundimin e ligjit, liritë individuale, tregtisë së lirë dhe paqes në botë. Komonuelthi është themeluar më 11 Dhjetor 1931 dhe qendra e tij është në Malborou Hauz në Londër – Angli (en.wikipedia.org)

REPUBLIKA E GUINESË



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Emri i plotë: Republika e Guinesë

Kryeqyteti: Konakri

Sipërfaqja: 245, 857 km².

Banorët deri më 2005: 10.211.437

Përqindja vjetore e rritjes së banorëve (2000 - 2005): 1.5 %.

Përqindja e myslimanëve: 85 %.

Gjuha: Frënge.

Monedha: Frangu i Guinesë (GNF)

Pavarësinë: 2 Tetor 1958 (nga Franca)

Anëtar i Kombeve të Bashkuara: 12

Dhjetor 1958

Anëtar i Konferencës Islamike: 1969

Si një ndër shtetet e Afrikës perëndimore Guineja zyrtarisht është e njohur si Republika e Guinesë, por formalisht njihet si Guinea Franceze. Guinea kufizohet në perëndim me Oqeanin Atlantik, ndërsa në veri me Senegalin dhe në veri e verilindje me Malin. Me Liberinë kufizohet në jug, ndërsa me Sierra Leonen në jug-perëndim. Konakri është qyteti më i madh, qyteti qeveritar dhe kryeqyteti i Guinesë. Shpeshherë ajo emërtohet edhe si Guinea Konakri për ta dalluar nga Guinea Bisao. Guinea është shtëpia e 24 grupeve etnike, por tre nga ato janë më kryesore e ato janë: Fula, Mandinka edhe Susu.

Duke pas parasysh afërsinë e saj me Malin dhe Senegalin, Guinea ka një histori të përbashkët me to. Guinea ka qenë krahinë e Mbretërisë së Ganës, pastaj e Mbretërisë së Malit, pastaj asaj të Songhajit.


Islami dominon në Guine në aspektin demografik, shoqëror dhe kulturor. Përpos tij ka edhe grupe të krishtera dhe banorë që ende i përmbahen feve vendase. Sikurse një pjesë e madhe e shteteve afrikane edhe ky shtet iu nënshtrua misionarizmit të krishterë, ku me të madhe punojnë grupe të ndryshme

e ndër më aktivët ndër ta janë evangjelistët.

Më 23 Dhjetor 2008 vdiq kryetari i vendit Lansana Konti pas një sëmundje të vështirë. Ky e kishte udhëhequr vendin për afro një çerek shekulli. Disa orë më pas një kolonel i ushtrisë Musa Dadis Kamara shpalli grusht shtetin duke urdhëruar dorëheqjen e qeverisë, revokimin e kushtetutës dhe ndalimin e aktiviteteve të tjera politike dhe formoi Këshillin Kombëtar për Zhvillim e Demokraci. E më 24 Dhjetor u shpall edhe kryetar i vendit.

Guinea ka burime të bollshme natyrore, së bashku me 25% të rezervave të njohura botërore të boksitit. Guinea gjithashtu ka diamant, ar dhe lloje të tjera metalesh. Vendi ka potencial të madh për energji hidroelektrike. Boksiti dhe alumini janë aktualisht eksportet kryesore. Guinea shpreson të zhvillojë hapjen e minierave të burimeve të tjera metalore. Industritë e tjera përfshijnë përpunimin e bimëve për lëngje, pije të buta dhe duhan. Bujqësia punëson 80% të fuqisë punëtore të vendit. Nën sundimin francez dhe në fillim të pavarësisë, Guinea ka qenë një eksportues i madh i bananes, kafesë, kikirikëve dhe vajit të palmës. ■

REPUBLIKA E GUINEA BISAO



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Emri i plotë: Republika e Guinea Bisao
Kryeqyteti: Bisao
Sipërfaqja: 36, 544 km².
Banorët deri më 2005 : 1.586.000
Përqindja vjetore e rritjes së banorëve (2000 - 2005): 2.4 %.
Përqindja e myslimanëve: 70 %.
Gjuha: Portugalishtja.
Monedha: Frangu i Afrikës Perëndimore (CFA)
Pavarësinë: 24 Shtator 1973 (nga Portugalia)
Anëtar i Kombeve të Bashkuara: 17 Shtator 1974
Anëtar i Konferencës Islamike: 1974

Republika e Guinea Bisao është shtet në perëndim të Afrikës dhe një ndër shtetet më të vogla në kontinentin afrikan. Ajo kufizohet me Senegalin në veri dhe me Guinenë në lindje dhe jug, ndërsa me Oqeanin Atlantik në perëndim. Guinea Bisao ka qenë koloni portugeze dhe me fitimin e pavarësisë nga Portugalia iu shtua emrit të saj emri i kryeqytetit Bisao, me qëllim që të bëhej dallimi me emrin e Guinesë.

Duke pas parasysh kufijtë me Senegalin, Islami në Guinea Bisao arriti qysh në kohën e Murabitunëve në fillim të shekullit të 11-të dhe shumë shpejt banorët e pranuan Islamin nga tregtarët dhe thirrësit myslimanë. Në vitin 1446 filluan forcat portugeze të hynin në Guinea Bisao dhe e kolonizuan atë, sa që ajo u quajt Guinea Portugeze. Në shekullin e 16-të ajo u shndërrua në burim për tregtinë e skllëvërve dhe kjo e gjendje e mjerueshme kolonizimi vazhdoi deri në vitet gjashtëdhjetë të shekullit të kaluar, kur u ngrit një lëvizje për arritjen e pavarësisë, të cilën e fituan më 1974.

GDP e Guinea-Bisao për frymë është një nga më të ulëtat në botë. Më shumë se dy të tretat e popullsisë së Guinea Bisao jeton nën kufirin e varfërisë. Ekonomia varet kryesisht nga bujqësia, industria e peshkut. Prodhon misër, oriz, vaj palmash, lëndë drusore. Guinea Bisao ende importon naftë, edhe pse janë zbuluar sasi të mëdha të saj, si dhe ka sasi të mëdha boksiti dhe fosfati.

Periodha e gjatë e paqëndrueshmërisë politike ka rezultuar me një depresion ekonomik, përkeqësim të kushteve sociale dhe rritjen e zhbancimeve makroekonomike. Guinea Bisao ka filluar të tregojë disa përparime ekonomike pas një pakti stabiliteti, që u nënshkrua nga partitë kryesore politike të vendit, duke çuar në një program të mbështetur nga FMN-ja për reformat strukturore në vend. Pas zgjedhjeve parlamentare në mars të 2004 dhe zgjedhjeve presidenciale në korrik të 2005, vendi është duke u përpjekur të marrë veten nga periodha e gjatë e paqëndrueshmërisë pavarësisht situatës ende të brishtë politike. ■

KËRKOJE NATËN E KADRIT

NGA: ALI SHABANI

Pyetje: Pothuajse në çdo *imsakije* vërejmë në natën e njëzetë e shtatë, anash e shkruhet se është Nata e Kadrit. Sa është i saktë ky përcaktim?

Përgjigje: Se sa është i saktë ky përcaktim vetëm Allahu e di më së miri, mirëpo atë që dimë ne sipas asaj që na ka treguar Allahu dhe i Dërguari i Tij, se Nata e Kadrit është në muajin Ramazan dhe në dhjetëditëshin e fundit të këtij muaji.

Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Ne e zbritëm atë (Kuranin) në Natën e Kadrit.”** [Kadër 1] Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: **“Nata e Kadrit është në dhjetëditëshin e fundit të Ramazanit, ai që falet në ato net duke llogaritur në**



shpërblimin e tyre, me të vërtetë Allahu do t'ia falë atij mëkatet e kaluara dhe të mëvonshme dhe ato janë netët teke: nata e 29, 27, 25, apo 23”. [Sahih] Mirëpo ajo që i ka çuar njerëzit ta përcaktojnë që Nata e Kadrit është nata e 27-ë janë disa hadithe. Prej tyre hadithi në Sahihun e Muslimit nga Ubej ibën Kabi, se Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: **“Ajo (Nata e Kadrit) me të vërtetë është nata e njëzetë e shtatë.”** Transmetim të njëjtë ka edhe nga Muavija, Ibën Omeri, Ibën Abasi dhe të tjerë. Disa nga selefët kanë bërë një orvatje ta nxjerrin këtë nga përemri *“ajo”*, ku aludohet për natën e Kadrit në Suren Kadër, se ajo fjalë është fjala e njëzetë e shtatë. Allahu e di më së miri

Pyetje: Pse i Dërguari i Allahut ka hyrë në itikaf në dhjetë netët e fundit të Ramazanit?

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.
Pyetjet mund t'i dërgoni në albislam@gmail.com

Përgjigje: Muaji i Ramazanit është muaji më me vlerë dhe netët i ka të bekuara me shumë shpërblime për adhuruesit e Allahut. Megjithatë në mesin e këtyre netëve është një natë që ka vlerë më të madhe dhe ajo është Nata e Kadrit, e kjo natë është në mesin e dhjetë netëve të fundit të Ramazanit. Kjo ka shkaktuar që Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* të hyjë në Itikaf, e të veçohet në xhami dhe në netët e fundit të bëjë ibadet dhe të jetë i sigurt që e ka takuar atë natë të madhe e të begatshme. Aishja radijallahu anha ka thënë: Pejgamberi është veçuar (në xhami) në dhjetëditëshin e fundit të Ramazanit dhe ka thënë: *“Kërkojeni Natën e Kadrit në dhjetëditëshin e fundit të Ramazanit”*. Buhariu. Me këtë dua të them, se kjo duhet të bëhet mësim për ata që mendojnë, se për çdo vit Nata e Kadrit është në natën e 27. Po të ishte kështu, Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* do të hynte në Itikaf vetëm në natën e 27-ë. Nga ana tjetër desha të theksoj edhe rastin, se Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* një ditë ka dalë t’u tregojë sahabëve se kur është ajo natë, mirëpo ka gjetur dy veta duke u grindur në xhami për një borxh që kishin pasur mes tyre dhe i ngritën zërat e tyre në çastin kur Pejgamberi deshi ta japi atë lajm. Në këtë rast Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* u tha atyre, se *kishte dalë t’u tregojë për Natën e Kadrit, por këta i ngritën zërat dhe Allahu ia largoi atë lajm nga mendja* dhe pastaj iu tha *kërkojeni (Natën e Kadrit) në netët 29, 27, 25, apo 23*. Meqë Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë që Allahu ia ka larguar nga mendja se kur është saktësisht (Nata e Kadrit) atij si pejgamber, atëherë çfarë na mbetet neve të tjerëve?! Më e mirë është zgjedhja e Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem*; kush ka mundësi le të hyjë në Itikaf, e kush nuk ka mundësi, atëherë le të shtrëngohet për ibadet më tepër në ato net.

Pyetje: Në Suren Kadër Allahu e ka përmendur zbritjen e Kuranit, se ajo ka ndodhur në Natën e Kadrit, ndërsa ne dëgjojmë nëpër ligjërata ndonjëherë ku përmendet zbritja e ndonjë ajeti, apo pjese të Kuranit jashtë muajit Ramazan. Si mund të na e sqaroni këtë?

Përgjigje: Vërtetë Allahu i Madhëruar ka thënë: *“Ne e zbritëm atë (Kuranin) në Natën e Kadrit.”* Kadër 1; dhe po ashtu edhe librat e tjerë qiellor kanë zbritur në muajin e Ramazanit. Na përcjell imam Ahmedi nga Vailete ibën Eska, se Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Fletushkat e Ibrahimit kanë zbritur në natën e parë të Ramazanit; Teurati ka zbritur pasi kanë kaluar gjashtë net nga Ramazani, Inxhili pas trembëdhjetë netësh të kaluara nga Ramazani dhe e ka zbritur Allahu Kuranin pasi kanë kaluar njëzetë e katër net të Ramazanit. Këto libra qiellorë dhe fletushka u kanë zbritur pejgamberëve të mëparshëm menjëherë, ndërsa Kurani ka zbritur menjëherë në “Bejtul ‘Izze” në Qiellin e Dynjasë, e pastaj ka zbritur në dynja (në formën e vahjit – shpalljes), i ndarë sipas ndodhive. Po ashtu qëndron në transmetimin e Ikremes nga Ibën Abasi, i cili ka thënë: “Kurani ka zbritur në muajin e Ramazanit, në Natën e Kadrit, në këtë qiell të dynjasë, e Allahu i ka bërë Pejgamberit ndodhi çfarë Ai ka dashur dhe çdo herë që vinin mushrikët me ndonjë shembull të kundërshtoheshin, Allahu sillte përgjigje. Kjo na tregohet në ajetin: *“E ata që nuk besuan thanë: “Përse të mos i ketë zbritur atij (Muhamedit) Kurani menjëherë?” Ashtu (e zbritëm pjesë-pjesë) që me të ta forcojmë zemrën tënde dhe Ne e sollëm atë ajet pas ajeti (dalëngadalë) Dhe ata nuk të sjellin ndonjë shembull ty, e që Ne të mos ta tregojmë të vërtetën, duke të ofruar shpjegim të qartë e të plotë.”* Furkan 32- 33.*

Pyetje: Pse Nata e Kadrit vlerësohet si më e mirë se një mijë muaj?

Përgjigje: Së pari Allahu i Madhëruar në vetë suren Kadër e ka treguar këtë vlerësim. Ai ka thënë: *“E ç’të bëri ty të dish se ç’është Nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e rëndësishme se një mijë muaj! Me lejen e Zotit të tyre (në atë natë) zbresin engjëjt dhe shpirti (Xhibrili) për secilën çështje. Ajo (që përcakton Zoti) është paqe deri në agim të mëngjesit.”* Kadër 1-5; d.m.th., një prej vlerave të kësaj nate është se zbresin melekët së bashku me Xhibrilin dhe zbret caktimi i Allahut për atë vit. Allahu i Madhëruar ka thënë: *“Në atë (natë) zgjidhet çdo çështje në mënyrë të prerë.”* Duhan 4. Si shkak që të përmendet Nata e Kadrit më e vlefshme se një mijë muaj është një tregim i Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem*, kur u ka rrëfyer sahabëve për njërin nga Beni Israilët, që kishte kaluar tetëdhjetë vjet në rrugë të Allahut. Sahabët kanë pyetur njëri-tjetrin, se ata nuk do të munden ta arrijnë këtë kontribut, se ndoshta edhe nuk do të jetojnë aq. Atëherë ka zbritur sureja Kadër, në të cilën thuhet se Nata e Kadrit është më e vlefshme se një mijë muaj, e po t’i llogarisim një mijë muaj dalin tetëdhjetë e tre vjet. D.m.th., muslimanët këtë vlerë mund ta arrijnë brenda një nate dhe ajo natë është Nata e Kadrit. Me këtë krahasim ia vlen që këtë natë ta kërkojmë në dhjetë netët e fundit të Ramazanit me një angazhim më të madh në ibadet dhe dua.

Pyetje: Vitet e fundit kemi dëgjuar për një dukuri të re, që në dhjetë netët e fundit të Ramazanit të thonë e falëm teravinë, e më vonë do të falim namaz nate. Si është paraqitur ky dallim dhe a është kjo nga praktika e Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem*?

Përgjigje: Së pari themi se i gjithë namazi i natës gjatë muajit të Ramazanit është një,

nuk bëhet dallim, siç e bëjnë disa nga njerëzit. Po megjithatë emërtimi i namazit të natës në muajin Ramazan me emrin “teravih” nuk është bërë në kohën e Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem*. Ky emërtim ka dalë më vonë. Në kohën e Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem* është njohur me emrin “kijamu Ramadan”. Një gjë tjetër në lidhje me këtë çështje është se vepra më e lavdëruar në namazin e natës në Ramazan është që të lexohet sa më tepër Kuran; d.m.th., kijami të jetë më i gjatë, e jo numri i rekateve. Vetë Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* në Ramazan dhe po ashtu jashtë Ramazanit në namaz nate ka falur vetëm tetë rekate, por është falur gjatë. Aishja radijallahu anhu ka thënë: *“I Dërguari i Allahut nuk ka shtuar në Ramazan e as jashtë Ramazanit më tepër se njëmbëdhjetë rekate.”* D.m.th., tetë rekate dhe tre vitër.

Pyetje: Çfarë mund të na thoni për Itikafin, vlerën dhe rregullat në lidhje me Itikafin?

Përgjigje: Itikafi është përmendur në Kuranin Madhështor. Allahu subhanehu ue teala ka thënë: *“...Ibrahimin dhe Ismailin i urdhëruam: ju të dy pastrojeni shtëpinë Time për vizituesit, për ata që qëndrojnë aty (akifin) dhe për ata që falen aty.”* Bekare 125. Itikafi pra duhet të bëhet në xhami dhe atë, vetëm në ato xhami ku falet namazi i Xhumasë. Allahu i Madhëruar e përmend këtë në ajetin: *“...E kur jeni të izoluar (në itikaf) në xhami, mos t’u afroheni atyre (grave për marrëdhënie intime)...”* Bekare 187.

Suneti i të Dërguarit ishte të hyjë në Itikaf në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, madje ka thënë: *“Kush ka bërë me mua Itikaf (më parë), le të hyjë në Itikaf në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit”.* Buhariu. ■

Nga përvoja e Shejh Akil ibën Muhamed Maktiriut

PËRKRAHJA E GRUAS

hoxha Mukbil El Vadiu kishte një kopsht me pula, ku punonin disa nxënës, më pas ky kopsht u mbyll, e kaloi një kohë pa punë, atëherë i erdhi ideja hoxhës që ta shndërron prej kopshtit për pula në kopsht për burra

LEMJA HALAHIME

Të nderuar, ky është një rrëfim i suksesit dhe i mundimit për hir të arritjes së diturisë dhe thirrjes, që më ka habitur shumë, kështu që desha ta lexosh edhe ti së bashku me mua. Le të lexojmë tregimin në gjuhën e rrëfyesit:

Ashtu sikurse njeriu që sakrifikon për të arritur ndonjë pozitë, udhëton dhe jeton në kurbet, rri deri në orët e vona, uritet dhe vuan lodhje e sëmundje, ashtu edhe gruaja ku sakrificat e saj mund të mos jetë për hir të vetes, por për hir të burrit të saj, e kjo është nga sakrificat më të mëdha.

Kjo më ndodhi mua gjatë rrugës në kërkimin e diturisë, në qytetin e *Hadides* ku edhe jetoja, në vitin 1404 të hixhretit (1984). Falënderimi gjithmonë i takon Allahut për jetesën e rehatshme, ku isha i punësuar në një punë private, pastaj u punësova në punë shtetërore dhe arrita një rrogë të madhe. Jashtë kësaj merresha edhe me tregti, kisha një banesë timen, të mirë e të përshtatshme, e në atë kohë isha hatib dhe ligjërues, mësoja dituritë fetare nga disa hoxhallarë, e unë kisha një dëshirë të fortë për t'iu përkushtuar kërkimit të dijes. Në disa udhëtime të hoxhës

tonë *Mukbil El Uadiut* –Allahu e mëshiroftë - i ra rruga nëpër qytetin e *Hadides*, ku dëgjoi për mua, e më kërkoi. Ai kërkoi nga unë që të udhëtoj deri në *Seadeh* për të marrë dituri. Kështu që shkova me të vetëm me qëllimin të përfitoj njohuri e dije. Atje gjeta një vend në një fshat të largët, ku jeta ishte tejet e vështirë në krahasim me atë ku isha unë në *Hadide*.

Gjatë dy ditëve kam ngrënë ushqim të rëndomtë, isha shumë i hutuar dhe hoqa dorë nga jeta në këtë vend pasi mendoja se si do të reagonte gruaja ime po të vija me te në këtë vend. Pas rishqyrtimit me disa vëllezër atje, vendosa që të qëndroj vetëm si një përvojë tregtie me një afat prej një ose dy muajsh, mirëpo unë jam njeri që ngutem, ndaj e mënjanova këtë ide dhe vendosa që ta provoj me gruan dhe fëmijët e mi. Shejh Mukbili, Allahu e mëshiroftë më siguroi një makinë të madhe, që të vij me familjen time dhe me gjërat e nevojshme, e të vijë me shokun tim dhe me familjen e tij – dashamirin Muhamed ibën Salim Zebidin dhe Nasir Kerim Zebidin. Kur arrita në *Hadideh* babait tim i kishte arritur lajmi dhe ai u nervozua shumë që unë e lashë punën. Atëherë ai jetonte në *Xhide*.

Edhe pse mua kjo më bëri të brengosëm shumë, por bëra durim, i mblodha pajisjet e

shtëpisë në një dhomë dhe e mbylla, mora me vete atë që kisha nevojë për përgatitjen e ushqimit, dyshek për mua dhe për gruan time, batanije, dy çarçafë, e dy dyshek për fëmijët Abdurrahmanin dhe Musabin, kalova nga Muhamed ibën Salimi dhe Nasiri dhe udhëtuam deri në Seadeh. Atje qëndruam në shtëpinë e Shejh Mukbilit dy ditë, unë me shokët e mi ishim në një xhami pastaj u transferuam në qytetin e Seades që të tre, u vendosëm në një banesë të bukur. Secili kishte dhomën me familjen e tij, ndërsa kishim një kuzhinë dhe një banjë, aty qëndruam përafërsisht një muaj e gjysmë, shkoni edhe në *Dimexh* pas drekës dhe ktheheshim pas jacosë me veturën time dhe gjatë kësaj kohe prisnim të lirohen disa banesa mirëpo kot. Pas kësaj u informova për një shtëpi që gjendej larg xhamisë dhe librarisë, kur vendosa që të kryej umren me gruan dhe fëmijët ishte muaji Ramazan, mora disa valixhe e u drejtova drejt shtëpisë së re për t'i vendosur aty pajisjet, gjeta një shtëpi duke u rrëzuar, brenda të shkatërruar, ishte gati të rrënohej, bile katit të sipërm i kishte rënë tavanin. Hapa drynin, aty kishte vetëm një dhomë dhe kishte nevojë për kuzhinë e banjë. Kjo dhomë e mbuluar me pluhur, ku merimangat kishin thurur edhe shtëpinë e tyre. Hyra brenda me gruan time që ta shikojmë banesën, dëgjoja rrahjet në gjoksin e saj, që e la shtëpinë të shtruar, të bukur, e të pajisur dhe që e la jetën e mirë që bënte, tinëz i shikoja sytë e saj duke mos i thënë asnjë fjalë, kur pashë se në sytë e saj rridhnin lotët në heshtje.

I vendosa gjërat në dhomën e braktisur, afër së cilës nuk gjendej asnjëri, as ujë e as rrymë, e mbylla derën, u nisa për ta kryer Umren dhe pasi e përfunduam u kthyem në Hadideh e prej aty në fshat, pastaj pas Bajramit në Seadeh herën e dytë. Në atë kohë na përmendën një shtëpi të vjetër të braktisur më shumë se pesëdhjetë vjet, që banorët e fshatit e konsideronin më të

bukurën, e ndërtuar prej balte, e përbërë prej katër katesh, ku në çdo kat kishte nga një dhomë, tavanet e çarë gati për të rënë, rinovuam atë që mundëm të përmirësojmë për të banuar aty. Në katin e katërt banonte Nasir Kerimi, në katin e tretë Muhamed ibën Salihu, unë banoja në katin e dytë dhe e ndava në dy pjesë, një për mua dhe gruan time dhe një për fëmijët, ndërsa në katin përdhes pronarët e shtëpisë vendosnin aty barin. Çdo kush prej nesh e kishte kuzhinën në korridor, në afërsi të dhomës dhe banjën në katin përdhes. Banorët e fshatit pritnin rënien e shtëpisë bashkë me ne, mirëpo Allahu na shpëtoi, bile disa herë është dridhur toka e nuk na goditi gjë, falënderimi i takon Allahut.

Dilnim nga shtëpia pas namazit të sabahut e ktheheshim pas drekës, që të vijmë në mësim pas drekës, e të kthehemi pas jacie. Po ashtu kishim mësim me familjet tona pas jacosë, e ky ishte orari ditor i yni. Pastaj hoxha Mukbil El Vadiu kishte një kopsht me pula, ku punonin disa nxënës, më pas ky kopsht u mbyll, e kaloi një kohë pa punë, atëherë i erdhi ideja hoxhës që ta shndërron prej kopshtit për pula në kopsht për burra, ku përfundoi ndarja e saj për gjashtë shtëpi, çdo shpi dy dhoma, një banjë dhe kuzhinë, një prej tyre ishte edhe hisja ime dhe Muhamed ibën Salihu kishte një, aty ishin edhe dy fqinj, që vazhduan të qëndrojnë derisa dolëm nga aty, pasi plotësuam gjashtë vite në rrugën e dijes dhe thirrjes. Mos të ishte dëshira e Allahut së pari, pastaj sakrifica e gruas time dhe durimi i saj në jetën e vështirë, nuk do të arrinim asgjë nga dituria që përfituam atje.

E lus Allahun subhanehu ue teala që ta shpërblejë me mirësi gruan time, po ashtu e lus Allahun e Madhëruar që ta përfshijë hoxhën tonë Mukbil Vadiun më mëshirën e tij të gjerë, me të vërtetë Ai është që dëgjon dhe i përgjigjet lutjeve. ■

Nga arabishtja: Shpend ZENELI